

DI
DRITA ISLAME

“Kryeqyteti ka nevojë për
nji Xhami të madhe e moderne”



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXIII i botimit
Nr. 10 (497)
Tetor, 2024

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Gëzimi i besimtarit është forcë rezëllitëse / Mehmet Disha

6 “Kryeqyteti ka nevojë për një Xhami të madhe e moderne” / Dorian Demetja

8 **Lajme / Aktivitete**



12 Për të folur në emër të Zotit duhet dije / Islam Hoxha

14 Dija ishte një pikë / Hikmet Adem

16 Nxitja e Islamit për arsimimin e gruas / Fatma Karaj

18 Çfarë janë paragjykimet fetare / Gazmend Leqini

22 Suneti i pastër i Muhamedit a.s., burim i pastër
për arsimin, kulturën dhe civilizimin islam / Xhemal Balla

26 Zemra jote, si toka e përhumbur / Ali Asakir

28 Familja në Islam / Redaksia



32 Edukata morale në filosofin arabe, Njif vet-vedin / Nebil Çika

34 Marrëveshja e Hudejbijes / M. Jusuf Kandeheleui

36 Ismail Maçi, veprimtar i shquar tiranas (1885-1960) / Faik Kasollla

38 Shoqëria e mirë / Lejla Dervishi



Gëzimi i besimtarit është forcë rrezëllitëse

Mirësia e Zotit pasqyrohet në shumë forma, herë si dritë për zemrën, herë si dije për mendjen, herë si fllad për shpirtin, herë si pëshpërimë për veshët e botës së brendshme të besimtarit dhe herë si e tërë në të gjitha format bashkë. Xhamitë janë strehë e kohëve të fundme, ku vëllazëria, uniteti, idealja janë gjithnjë në konstrukt, gjithnjë në përparim e sipër, herë forcohen, herë erërat e dynjasë i luhasin, por që ato janë aty, në shtëpinë e Zotit, Ai i ruan, i mirëmban, qoftë edhe në farëra të vogla dhe i lë aty, i fsheh pas një shkaku të vogël në të dukshmen, që presin lutjet tona të çelin për të vënë në lëvizje Fuqinë që fle në të padukshmen... dhe i mirë është ai që ndërton se për të shembur është kollaj!

Në xhamitë e Zotit lartësohet Emri i Tij dhe emri i të Dërguarit të Tij Fisnik (s.a.s) duke treguar se mirësia është ndjekja e fjalës së Zotit, Kur'anit dhe ecja në hapat e Sunetit Profetik. Kjo është udha e drejtë. Pavarësisht lodhjes, vështirësisë dhe ngecjes në rrugë, natën në të cilën kumbon fjala e Allahut që përçohet nëpërmjet shembullit të Muhamed Mustafasë (s.a.s.) e pason medoemos mëngjesi. E, a s'është mëngjesi afër? Kështu thanë engjëjt duke e ditur mirë se ndihma e Zotit është afër besimtarëve.

Po, gëzimi i besimtarit është forcë rrezëllitëse. Kurrë nuk mund të jetë e barazvlefshme forca e urrejtjes së njerëzve të prishur, me potencialin e buzëqeshjes së



njerëzve të Zotit. Nuk mund ta lrahasosh vëllimin e tunxhit me atë të floririt, secila ka vlerën përkatëse por që diferenca është sa malet. Pak me Zotin është shumë. Kjo anë e fortë e premtimit të Zotit, që gjithnjë ata që qëndrojnë në anën e Tij, në grupin e Tij, do të jenë fitimtarë, është më se e mjaftueshme për këdo që ka arsye dhe logjikë të lexojë rrjedhën e ngjarjeve dhe të historisë.

Tashmë Tirana ka një xhami të madhe. Është kryer amaneti i brezave që, prej një shekulli, ngrenin zërin se kryeqytetit i duhej një e tillë. E, falë Zotit, jo vetëm që u krye si porosi, me lejen e Tij, por njësoj si atëherë, veshët e shpirtave tanë ëmbëltohen nga zëri i ëmbël i ezanit që përçohet nëpërmjet minareve të

larta, dhe sytë e zemrat na ndriçohen kur shohim besimtarë të shumtë që mbushin radhët e xhamisë, me plot të rinj e të reja, që janë në rrugën e Zotit dhe të Profetit të Tij (s.a.s).

Allahu e bëftë udhën e besimtarëve të lehtë në dynja dhe në ahiret. Zoti na mundësoftë të jemi në kahun e të mirës, Zoti e udhëzoftë rininë tonë drejt besimit dhe moralit dhe na forcoftë në përpjekjet e singerta dhe të qëndrueshme në luftën ndaj së keqes! Allahu e lartësoftë Islamin dhe besimtarët.

Amin!

Mehmet Disha



Kryeqyteti ka nevojë për një Xhami të madhe e moderne

Me këtë titull hapet artikulli i revistës “Zani i Naltë” në vitin 1938. Aty lexojmë se qysh atëherë, edhe me rritjen e numrit të popullsisë, shprehet nevoja për një xhami të madhe, ku t’i mbledhë të gjithë besimtarët për ceremoni dhe lutje të përbashkëta, sidomos në festa fetare dhe kombëtare. Aty gjithashtu flitet edhe për pamundësinë financiare për ndërtimin e saj nga institucioni, si dhe iniciativën që duhet të marrin bujarët e kryeqytetit në këtë drejtim.

Një nga vendet më karakteristike të shekullit XIX është rregullimi i sheshit të Namazgjasë nga Ahmet Bej Toptani, i biri i Abdurrahman

Toptanit. Namazgjasë përdorej gjatë verës për mbledhjet e qytetarëve dhe faljet e tyre gjatë muajit të Ramazanit dhe Bajramit. Rrënojat e mureve dhe selvitë qindraveçare flasin për lashtësinë e saj. Prandaj dhe kërkesat e Komunitetit Mysliman në vazhdimësi kanë qenë që xhamia e madhe të ndërtohej pikërisht në truallin e Namazgjasë.

Trualli i Namazgjasë u pa më i përshtatshëm për funksionimin e tij si një faltore e hapur me një mihrab dhe një minber, pastaj dhe me murin rrethues. Më 17.08.1943, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë i dërgon Bashkisë së Tiranës një shkresë të shoqëruar me tri lidhje

të planit të Namazgjasë, si për rrethim ashtu edhe për objektet e brendshme, me të cilat kërkon edhe lejen e ndërtimit të tyre. Tri ditë më pas, Drejtoria Teknike në Bashkinë Tiranë, shprehet në favor që Vakëfit Mysliman t'i akordohet leja për ndërtimin e Namazgjasë sipas projektit përkatës. Nuk e dimë me saktësi nëse ky projekt gjen zbatim në atë kohë.

Në bazë të kërkesës datë 20.04.1993, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë së Tiranës, me dt. 04.10.1993, nr. 13, vendosi dhënien e lejes së ndërtimit për objektin Xhaminë e Namazgjasë, e cila është firmosur nga Kryetari i Bashkisë z. Sali Kelmendi. Subjekti që zbaton punimet është M.A.K. Albania Al-Kharafi Industries & Establishments dhe objekti financohet nga Shoqata Islame e Vakëfit. Megjithëse guri i themelit u vendos dhe ceremonia u zhvillua, kjo mbeti deri këtu, sepse në shtator të vitit 1994 punimet u pezulluan.

Ndërkohë, Komuniteti Mysliman vazhdon kërkimin e donatorëve për ndërtimin e xhamisë dhe një qendre kulturore me takime dhe vizita të vazhdueshme në Komunitetin Mysliman të Turqisë, Ministrinë e Çështjeve Islame- Vakfeve në Kuvajt dhe me autoritete të larta të Mbretërisë së Arabisë Saudite, të cilët shprehin gatishmërinë dhe premtojnë për ndërtimin e tyre.

Në maj të vitit 2011 ka pasur një nismë nga Bashkia e Tiranës për ta ndërtuar xhaminë e madhe në Tiranë prapa Pallatit të Kulturës, sipas projektit fitues danez i Studios "BIG-Kopenhagen", por që Komuniteti Mysliman nuk ka rënë dakord. Kryesia e KMSH-së në mbledhjen e posaçme të datës 20.09.2011, analizon edhe një herë të gjitha detajet për ndërtimin e xhamisë së madhe në Tiranë, e shumëpritur kjo prej kohësh. Në këtë mbledhje, Komuniteti Mysliman shprehet i vendosur që xhamia e madhe të ndërtohet në sheshin e Namazgjasë, tokë kjo e trashëguar brez pas brezi si vend për të falur namaz.

Përpjekjet dhe orvatjet për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë u mbyllën përfundimisht në vitin 2013, me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit për leje zhvillimore komplekse, firmosur nga Kryetari i tij z. Sali Berisha. Guri i themelit për ndërtimin e Xhamisë së Madhe të Tiranës u rivendos më 20 prill 2013 me ceremoninë e fillimit të punimeve në sheshin Namazgja.

Me datë 24.09.2013 në Ankara dhe në

Tiranë, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Selim Muça, nënshkruan me Prof. Dr. Mehmet Gormez, Kryetar i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Republikës së Turqisë dhe Kryetar i Këshillit Administrativ të Fondacionit për Fenë i Turqisë, një protokoll kuadër lidhur me ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë dhe kompleksit të saj.

Me ndërrimin e qeverive, po në vitin 2013, kemi edhe një ndryshim në vendimin për lejen zhvillimore komplekse të dhënë më parë, ndryshim i cili miraton vetëm ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë, në bashkëpunim me zhvilluesin "Komunitetin Mysliman Shqiptar". Vendimi është i firmosur nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, z. Edi Rama.

Hedhja e themeleve për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë në Tiranë, u krye më 13 maj 2015, në prani të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, Presidentit të Republikës së Turqisë, z. Rexhep Tajip Erdogan, Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Skender Bruçaj, Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Turqisë, z. Mehmet Gormez, dhe personaliteteve të rëndësishëm nga Shqipëria e Turqia.

Xhamia e Namazgjasë ka elementë shqiptarë të një stili klasik ballkanas. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 6000 m² në vendin e njohur si Namazgjaja e Tiranës, me kupolën e lartë 35 metra dhe katër minaret, lartësia e të cilave shkon në 50 metra. Brenda në xhami mund të falen njëkohësisht rreth 5000 besimtarë.

Xhamia e Namazgjasë është një kompleks multifunksional, ku të gjitha funksionet janë të hapura për publikun. Aty përfshihen qendra kulturore, salla e madhe e konferencave me kapacitet rreth 320 vende, një sallë tjetër më e vogël, biblioteka. Projekti lë hapësirë edhe për realizimin e një muzeu islam, i cili do të jetë i pari në Shqipëri në llojin e tij. Në projekt përfshihen parkingu me dy kate nëntokë, si dhe një numër i konsiderueshëm dyqanesh e ambientesh shërbimi.

Lusim Allahun e Madhëruar që me realizimin e ëndrrës shumë vjeçare të besimtarëve myslimanë të Tiranës e mbarë besimtarëve shqiptarë, ta bekojë këtë xhami me mirësitë e Tij të pafundme, ta bëjë një vend ku lartësohet dhe nderohet emri i Tij me adhurime e lutje të sinqerta, ta bëjë një vend ku përhapet dija, dashuria dhe respekti për të gjithë.

Dorian Demetja



1

PROJEKT BAMIRËSIE ME FONDACIONIN ZVICERAN "SWISS BARAKAH CHARITY"

Nën kujdesin e z. Bujar Spahiu, kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe me mbështetjen e fondacionit zviceran "Swiss Barakah Charity" dhe disa donatorëve të tjerë individë, në kuadër të fillimit të vitit të ri shkollor, KMSH shpërndau çanta shkollore të pajisura me mjete mësimore për rreth 200 fëmijë të shkollave fillore e nëntëvjeçare në rrethet e Tiranës, Librazhdit, Gramshit, Peqinit dhe Përmetit nëpërmjet myftinive përkatëse.

Fëmijët përfitues nga ky projekt shprehën falënderimet e tyre të përzemërta për dhuratat që morën.

Projekti u zbatua nga Forumi Rinor Mysliman i Shqipërisë - FRMSH në bashkëpunim me myftinjtë dhe imamët përkatës nëpër rrethet e lartpërmendura.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë uron të gjithë nxënësit dhe mësuesit për një vit sa më të mbarë e të suksesshëm!





2

**ÇELET EKSPOZITA KULTURORE ME TITULL "MBULESA E QABESË SË BEKUAR"
NË AMBIENTET E XHAMISË ET'HEM BEU**

Në ambientet e xhamisë Et'hem Beu në Tiranë, zhvillohet ekspozita kulturore me titull "Mbulesa e Qabesë së Bekuar", aktivitet ky i organizuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Arabisë Saudite në vendin tonë.

Kjo ekspozitë e mbulesës së Qabesë vjen për herë të parë në Shqipëri si ekskluzivitet kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ndër sendet e ndryshme me vlerë që janë ekspozuar dhe që do të vazhdojnë të ekspozohen gjatë ditëve në vijim, është edhe një copëz nga mbulesa e Qabesë (كسوة الكعبة المشرفة) e cila do të përdoret në sezonin e ardhshëm të ritualit të haxhit.

Në ceremoninë e hapjes së kësaj ekspozite, ndër të tjerë ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu dhe zv. Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në vendin tonë, z. Ahmed el-Harbi.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, shtoi rëndësinë kulturore që ka kjo ekspozitë për besimtarët në veçanti por edhe për të gjithë ata turistë që vizitojnë çdo ditë xhaminë simbol të kryeqytetit, duke u dhënë atyre mundësinë të njohin nga afër procesin e qendisjes dhe të mirëmbajtjes së mbulesës së vendit më të shenjtë në botë të fesë Islame. Po ashtu ai falenderoi Ambasadën për bashkëpunimin dhe jetësimin e këtij projekti.

Ndërsa zv. Ambasadori falenderoi Kryetarin për gatishmërinë e treguar në konkretizimin e kësaj ekspozite në pasqyrimin e kësaj vlere të veçantë kulturore të besimit tonë.

Më tej, të lartpërmendurit prejnë në mënyrë simbolike shiritimin e çeljes së kësaj ekspozite.





3

PROGRAM MEVLUDI NË XHAMINË "ET'HEM BEU"

Në kuadër të muajit Rabiul Euel, në xhaminë Et'hem Beu u zhvillua një program fetar kushtuar Profetit Muhamed (a.s).

Të pranishëm për të ligjëruar për besimtarët e mbledhur me këtë rast, ishin Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Nënkryetari Lauren Luli dhe imami i xhamisë, z. Elton Karaj.

Gjithashtu gjatë këtij programi u lexua Kuran nga hafizi Enes Hyka dhe një pjesë mevludi nga muezini i xhamisë, Osman Kabili.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, u ndal në ndryshimet që solli në këtë botë ardhja e Profetit (a.s) në aspektin adhurimor, atë social, humanitar, edukues, etj.

Ndërsa nënkryetari Luli, theksoi shembullin e Profetit Muhamed (a.s), si shembullin më të mirë për njerëzimin, për paqen, për mirësitë dhe për mënyrën se si ti drejtohem Allahut (xh.sh) në adhurimet tona.

Mevludi është një nga traditat e myslimanëve shqiptarë. Besimtarët kanë rregulluar gjithmonë një përkujdesje të veçantë për të, duke e ruajtur këtë traditë ndër shekuj. Kjo, në një fare mënyre, është shenjë mirënjohjeje dhe dashurie ndaj Profetit Muhamed a.s.

Profeti Muhamed lindi ditën e hënë, më 12 Rebiul-Evvel, në vitin 571 në Mekë.





4

INAUGUROHET XHAMIA "TULIPAN" NË REINACHUT TË ZVICRËS

Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit të xhamisë shqiptare "Tulipan" në Reinachut të Zvicrës.

Në këtë organizim ishin të pranishëm kryesia dhe imami i xhamisë "Tulipan", përfaqësues të bashkësive fetare të Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Luginës së Preshevës, Zvicrës, autoritet lokale të zonës, si dhe një numër i konsiderueshëm besimtarësh.


Në fjalën e tij përshëndetëse, nënkryetari Luli, uroi dhe përgëzoi të gjithë kontribuuesit për ndërtimin e kësaj xhamie. Më tej, ai u ndal në vlerën e tyre në përditshmërinë e besimtarëve dhe komunitetit në përgjithësi.

"Xhamitë janë shtëpitë e Zotit, janë vende ku përmendet e lartësohet emri i Tij, janë vende ku forcohen lidhjet mes njerëzve që duhen për hirë të Allahut. E dashuri më të madhe se ajo që ndodh pa interesa të kësaj bote, por vetëm për kënaqësinë e Zotit, nuk ka."- tha ai.

Më tej aktiviteti vijoi me fjalë të tjera përshëndetëse dhe shpërndarjen e disa certifikatave felenderimi për kontribuesit dhe të gjithë ata që bënë të mundur realizimin e këtij projekti.



PËR TË FOLUR NË EMËR TË ZOTIT DUHET DIJE



Ai njeri, i cili flet për fenë dhe parimet e saj, domosdo duhet të jetë i pajisur me njohuri fetare e të bazuara dhe bindjen se është duke folur mbi një gjë të drejtë. Po ashtu, duhet të jetë i vetëdijshëm për ndikimet e predikimit të tij në funksion të orientimit të drejtë të njerëzve kah rruga e drejtë. Kjo do të thotë largim prej dënimeve të xhehenemit dhe fitim i kënaqësive të xhenetit. Ata që flasin për fenë, domosdoshmërisht duhet të kenë dy cilësi a virtute: përveç asaj që fjalët të jenë në përputhje me veprat, veprat e tyre, të mbështetura në parimet e fesë, duhet t'ua kalojnë fjalëve dhe, së dyti, zbatimi praktik i normave të fesë, duhet të jetë program i jetës së tyre të përditshme. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të bëhen shembull për dëgjuesit e tyre. Aftësia predikuese për të folur rreth çdo fushe të dijës e veçanërisht rreth bazave dhe hollësive të fesë, gjithashtu është e domosdoshme, sepse vetëm një predikues i këtillë do të mund të zgjojë interes te dëgjuesit dhe vetëm kështu fjalët e tij do të kenë rol dobishjellës.

Selefët, të parët e nderuar, nuk ia lejonin vetes të flisnin për fenë, derisa të pajiseshin me dije të sakta dhe të lejoheshin për këtë prej mësuesve apo orientuesve të tyre.

Rëndësi të veçantë ka edhe njohja e gjuhës - përkatësisht gjuha shqipe, sepse predikuesi duhet të jetë shumë i qartë në të shprehur e kjo arrihet me anë të mos përdorimit të frazave të thata, alegorive ose përsëritjeve të panevojshme. Mjerisht, tani, shumë rrallë mund të haset në njerëz tillë, të cilët janë të matur në fjalë.

Shpeshherë, duke dëgjuar hatibin (ligjëruesin në hytbe), kuptojmë se ai është krejtësisht i papërgatitur, sepse ligjërata e tij fillon me fjalë të pakuptimta, shfaq gjithfarë mendimesh, të cilat nuk kanë lidhje as me temën e as me jetën, bën kalime nga njëra temë në tjetrën, ngre zërin, bën lëvizje të panevojshme me dorë, tund kokën e bashkë me të edhe trupin. Përveç këtyre gjesteve, nuk bën asgjë tjetër. Prandaj me të drejtë dëgjuesi pyet: Çfarë tha hoxha? Për të qenë të sigurtë themi: Asgjë.

Është më mirë të flasësh pak e kuptueshëm se sa të flasësh shumë e të jesh i pakuptueshëm. Pejgamberi a.s. fliste pak, por ligjëratat e tij, edhe pse të shkurtra, janë ndër më të dobishmet. Kuptohet se ligjëruesit, madje edhe atij më të aftit, i duhet përgatitje, shfletim burimesh të shumta, jo vetëm nga literatura e hershme, por edhe ajo bashkëkohore. Duhet mbajtur shënime për temën në fjalë, në mënyrë që radhitja e gjërave, që do të shpjegohen, të bëhet në mënyrë kronologjike. Në të kundërt, përveçse do të konsumoheshin fjalë të pavlefshme, do të mërzhitej edhe masa e dëgjuesve.

Koha kur çmohet çdo lloj llafazanërie ka kaluar. Sot është koha e fjalëve të pakta, por të dobishme.

Nuk kemi nevojë për ligjërata rreth së njëjtës çështje, përsëritje të temave e tregimeve të njëjta për çdo hytbe, lexim të hytbeve të shkruara para një shekulli e më tepër, vlerën e të cilave e ka konsumuar koha. Sot është koha të flitet për moralin, kulturën e humanizmin, sepse vetëm pas formimit të njeriut me të gjitha cilësitë e duhura, do të vlejë zbatimi i detyrave dhe i obligimeve të fesë. Për këtë çështje duhet të orientohemi nga praktika kur'anore, nga e cila mësojmë se Zoti xh.sh. trembëdhjetë vjet me radhë u foli njerëzve për moral, humanizëm, kulturë, etj., dhe vetëm pasi arriti ta ngrinte masën e njerëzve në nivelin e duhur, filloi t'i ngarkojë ata me detyrime.

Islami mund të praktikohet i parë nga shumë drejtime, për këtë neve na është lënë shumë hapësirë. Kultura botërore është burimi mendimeve unike të shumë popujve, por esenca e mendimeve të dobishme është tek Islami. Një mysliman nuk mund dhe nuk duhet të ketë mendime të dëmshme në kokë. Pra, ligjëruesi duhet të dijë të dallojë e të mënjanojë të gjitha ato mendime të dëmshme me të cilat Islami nuk ka asgjë të përbashkët.

Islami është tërësia e pandarë, është themel, mësimet dhe bazat e tij nuk ndryshojnë e as nuk vjetrohen. Çdo mësim a ide tjetër mund të ndryshojë brenda një periudhe të gjatë a të shkurtër kohore, por Islami kurrsesi nuk mund të jetë i tillë dhe kjo për shkakun se buron nga Allahu xh.sh.

Duhet ditur se të gjitha tekstet fetare nuk japin asnjë kontribut, nëse ato mbeten vetëm të dhëna të papraktikuara.

Duhet të jemi të vetëdijshëm se të folurit rreth fesë ka dy tehe: e para, nëse flitet me maturi dhe pjekuri, dëgjuesit kanë dobi, feja për ta fiton kuptim të lartë, bën që ligjëratat të dëgjohen, e dyta, nëse flitet shkel e shko, dëmtohen dëgjuesit, ulet shkalla e kuptueshmërisë dhe interesi për fenë, pra dëmtohet feja.

Një bindje duhet të jetë e patundshme, që fjalët e pashoqëruara me vepra nuk kanë kurrfarë efekti. Pra, neve na duhen dijetarë që flasin e veprojnë njëlloj, sepse ka dijetarë, të cilët, me gjithë titujt që kanë, nuk kanë arritur të bëjnë as edhe një njeri për vete.

Shpresoj se lexuesit e nderuar do të gjejnë gjuhën e përbashkët dhe do të ndihmojnë për përmirësimin e gjendjes atje ku ka nevojë.

Islam Hoxha

DIJA ISHTE NJË PIKË

Pika është një tërësi e pandarë, pa pjesë dhe ndarje, dhe për këtë arsye simbolizon unitetin dhe njëshmërinë. Kur e mendojmë dijen si një pikë, personi që është i vetëdijshëm për këtë tërësi dhe që mund ta shohë atë në tërësinë e saj menjëherë, është një dijetar i vërtetë. Nëse dëshiron, ai mund ta hapë atë tërësi në mendjen e tij përmes arsytimit, duke e zgjeruar atë. Ai që fillon të flasë dhe të pyesë për atë tërësi, ende nuk është i vetëdijshëm për atë dije. Si për shkak se nuk mund ta kuptojë të tërën njëherësh, ashtu edhe për shkak se flet aty ku duhet të hesht...

Deri këtu kemi hyrë në fushën e mendimit të dy filozofëve: Descartes dhe Wittgenstein. Descartes (1596–1650) kërkoi një dije për të cilën nuk mund të kishte asnjë dyshim. Ai vendosi se kjo ishte ekzistenca personale si një subjekt mendues. Sepse fakti që ne mendojmë, domethënë që jemi individë që mendojmë, është një e vërtetë aq e qartë sa nuk lë vend për asnjë dyshim. Atëherë, secili prej nesh mund të thotë: "Mendoj, pra jam.". Domethënë, ekzistenca ime është një e vërtetë e padyshimtë. Duke nisur nga kjo pikë, Descartes përpikëj të

tregonte se mund të arrinim në të vërtetat, duke përfshirë ekzistencën dhe njëshmërinë e Zotit (celle celâluhu), dhe se mund të përgjigjeshim ndaj pyetjeve metafizike. Këto arsyetime formuan themelin e filozofisë së Descartes.

Wittgenstein (1889–1951), nga ana tjetër, argumentoi se edhe nëse jemi të vetëdijshëm për disa fakte, ato nuk mund të shprehen. Për të ekzistenca ishte sekreti më i madh dhe mrekullia më e qartë. Gjuha mund të shprehë marrëdhëniet midis entiteteve, por kur bëhet fjalë për pyetjen se çfarë është ekzistenca ose pse ka diçka në vend të asgjëje, ajo ngec, nuk mund të ecë përpara dhe mbetet e pafuqishme. Thënia e famshme e Wittgenstein, "Duhet të heshtësh për gjërat për të cilat nuk mund të flitet."¹ në njëfarë kuptimi, përmbledh filozofinë e tij dhe

1. Kjo fjali (gjermanisht: "Wovon man nicht sprechen kann, darüber muss man schweigen.") është fjalia e fundit e Tractatus Logico-Philosophicus të Wittgenstein dhe shpreh një mendim mbi kufijtë e gjuhës dhe mundësitë e të folurit kuptimplotë. Ludwig Wittgenstein, Tractatus Logico-Philosophicus Logisch-philosophische Abhandlung, London: Kegan Paul,

tregon kufirin që ai arriti duke menduar.

Çfarë është kjo pikë që mbledh dijet brenda vetes? Ashtu siç e dimë me siguri se ekziston "ene"-ja (uni personal) që tregojmë me fjalën "unë", po ashtu e dimë qartë se qenësia e "ene"-së nuk është nga vetvetja, dhe përmes kësaj mund ta njohim ekzistencën dhe unitetin e Allahut (xh.xh). Çdo gjë mbështetet tek Ai, dhe Qenia e shenjtë, që i ka dhënë ekzistencën dhe të gjitha cilësitë krijesave të Tij, nuk ngjan me to, pra nuk mund të përfshihet dhe të matet në përmasat e ma siva (arab. gjithçka përveç Allahut).² Njohja e çdo gjëje që mbështetet tek Ai, si dhe krahasimi i saj me pikën, do të thotë të dish se Allahu (xh. xh) është i pranishëm dhe i vetëm.

Çdo shkencë dhe filozofi kërkon të arrijë një sistem të qëndrueshëm brenda vetes. Kërkimet shkencore pranojnë të vërtetën e asaj që ekziston dhe ndjekin rrugët që i përshtaten asaj. Edhe teoritë shkencore që kundërshtojnë njëra-tjetrën, përfundimisht treten brenda të njëjtës së vërtetë. Çdo gjë është e kufizuar me mundësinë e shprehjes së saj me anë të gjuhës.

Integriteti i shkencave

Evropa po kalon një krizë kulturore. Ky gjendje ka filluar të ndihet edhe në rrethet filozofike. Përgjigjet e dhëna ndaj pyetjeve mbi të vërtetën dhe dijen po i kalohen njëra-tjetrës, duke përkeqësuar krizën kulturore që po formohet në kohën tonë. Kjo gjendje [teori-H.S] sipas filozofit gjerman Max Scheler (1874–1928), është rezultat i ndarjes së punës. Ndërsa fushat e specializuara fitojnë pavarësi nën dominimin e parimit "shkenca për shkencën", ato po shpëputen nga njëra-tjetra dhe po bëhen të huaja ndaj njëra-tjetrës. Në mendimin perëndimor, ekziston një lidhje mes kësaj "krize" që përjeton dhe ndikon të gjithë botën, dhe copëtimit të shkencës nën emrin e "specializimit" dhe daljes së shkencave. Thënia e Aliut (radjallahu anhu) "Dija ishte një pikë, të paditurit e shtuan atë." hedh dritë mbi problemin e sotëm.

Edhe pse shtimi i dijes shihet sot si një zhvillim dhe përparim, kur shihet nga ekspertët, përmban gjithashtu një rrezik të madh. Çfarë është ky rrezik? Shkencat, duke u shpëputur nga burimi i dijes dhe duke u ndërtuar mbi disa parime që nuk janë hyjnore, në thelb injorojnë Atë që sjell shkakun e çdo gjëje në lëvizje (Musebbibu'l-Esbab).

Kur e shqyrtojmë çështjen nga pikëpamja fizike, adhurimi i shkakut të natyrës, duke u shkruar me shkronjë të madhe si "Natyre", i shkakut që është një perde, dhe vendosja e "ligjeve fizike" si një perde e veprimit të Allahut, në vend që ta njohim vullnetin e Tij si shkakun e vërtetë, është një normë që tashmë ka zënë vend. Fizikantët që besojnë, natyrisht, i shohin këto ligje si një manifestim të vullnetit të Allahut, por kur Kur'ani thotë "Ai është Ai që bën të bie shi" (Shura, 42/28), shumë fizikantë detyrohen të thonë, "Shiu është një fenomen natyror, është rënia e avullit të ujit që shkaktohet nga graviteti".

Shkenca e shpjegon reshjen e shiut përmes disa shkaqeve të caktuara. Por feja, që në fillim, e konsideron shiun si një mëshirë. Këndvështrimi fetar është më përfshirës dhe më njerëzor. Sigurisht që të dyja kanë vendin e tyre. Shkenca zbulon ligjet që veprojnë në univers dhe përpiqet të shpjegojë ngjarjet me to. Por kush i vendosi këto ligje në fillim? Përpjekja shkencore është si të vendosësh pjesët e një puzzle së bashku. Allahu, me mëshirën e Tij, e ka krijuar universin në mënyrë që të kuptohet. Por përballë dijes së pafundme, a nuk është mendjemadhësi dhe arrogancë të mburrësh sepse kemi gjetur disa pjesë të puzzle dhe të pretendojmë se dimë çdo gjë ose mund të dimë?

Një vizion kozmologjik i bazuar në koncepte shpirtërore është shumë më i saktë dhe shpjegues sesa një vizion i bazuar në atomet. E vërteta e gjërave bazohet në manifestimet e emrave të Allahut. Për të kuptuar të vërtetën e gjërave, duhet të përgjigjemi në pyetjen "Çfarë është ekzistenca?". Ai që e bën dhe i përgjigjet kësaj pyetje është njeriu. Të shohësh shkencat si të pavarura nga njeriu dhe si të vërteta absolute është një gabim. Paradigmat e pranuar nga njerëzit i japin drejtim shkencës dhe madje shërbejnë si bazë për shkencën.

Kur themi "Shiu është një mëshirë e mishëruar", gjërat që sapa përmendëm bëhen më të qarta. Zoti ynë na dërgon shiun duke na trajtuar me mëshirë. Për foshnjën e sapolindur, Ai tregon mëshirën e Tij përmes nënës së saj duke i dhënë qumësht dhe dashuri. Kjo është mëshira e vërtetë. Elementët materialë dhe shkaqet janë pasqyra të reflektimit të aspekteve të ndryshme të asaj mëshire. Kur shpjegojmë shiun, ajo që është më rëndësi është të kuptojmë se kush i krijoi retë, avullimin dhe kondensimin. Këto shkaqe fizike, që çojnë në reshje shiu, janë të ngjashme me shumë shfaqje të hapura të urtësisë, mëshirës dhe jetës. Kur e shohim, emri Hajj (Zoti i përjetësisë) i Allahut (xh.xh) rrethohet nga emrat 'Alim (Ai që di çdo gjë), Kadir (Ai që ka pushtet mbi çdo gjë) dhe Rezzak (Ai që furnizon të gjitha krijesat), dhe mijëra emra të tjerë të Tij, që manifestohen në një zinxhir të attributeve të urtësisë. Shkaqet janë përcaktuar si një pjesë e krijimit të qenieve të gjalla; qeniet janë një tërësi ligjesh dhe rregullash që tregojnë për urtësinë e krijuar nga Allahu. Ato tregojnë për ne kuptimin e kësaj urtësie. Zbulimet e njeriut, njohuritë që të habisin dhe rregullat, harmonitë, masat dhe ekuilibrat e ndjeshëm, të gjitha këto janë ndërmjetës për të përkthyer të vërtetat e shenjta. Shkencat; nëse ushqejnë kureshtjen e njeriut për të vërtetën dhe e ndihmojnë atë të thellohet në besim, që i shërbejnë njerëzimit dhe virtyteve, atëherë ato fitojnë vlerë.

Nga turqishtja Haki Sahitaj

²1922, (botimi i 8-të: 1960), fq. 188.

Nxitja e Islamit për arsimimin e gruas



“A mund të jenë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?”¹

Njerëzimi përgjatë gjithë historisë në shoqëri të ndryshme ka vazhduar ta keqtrajtojë gruan duke mos i njohur asnjë të drejtë asaj. Për të ndrequr dhe korrigjuar këtë rrugë të shtrembër që ka ndjekur njerëzimi në lidhje me keqtrajtimin e saj feja Islame i erdhi në ndihmë duke i lënë vendin që i takon në legjislacionin Islam. Revolucioni që kreu islami qe shpëtimi i gruas. Vetëm Islami ishte ai që pranoi dhe i njohu plotësisht të drejtat e saj. Në lidhje me të drejtën për arsimim, po të shohim më gjerësisht feja Islame si fe e civilizimit dhe e integritimit, është e vetmja që ka ofruar formulën më të mirë për zgjidhjen e problemeve po në këtë plan.

Kurani, i zbritur katërbëdhjetë shekuj më parë, filloi me urdhrin “Lexo!” “Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (ç’do gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujar! Ai që e mësoi njeriun të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte”. (Alak, 96:1-5)

Allahu ka kërkuar nga njerëzit që të kërkojnë diturinë. Shumë ajete në Kur’an e shumë hadithe, i referohen rëndësisë që ka dija dhe i obligojnë njerëzit në kërkimin e diturisë. Kështu që Islami e bëri obligim kërkimin e diturisë si për burrat ashtu edhe për gratë.

H. Muhamed a.s., në një thënie të tij obligon të dy gjinitë për dije: “Kërkimi i diturisë është obligim për ç’do besimtarë dhe besimtarë”

I Dërguari i Allahut a.s me mësimet e tij nisi të ndërgjegjësojë burrat e të ngrejë pozitën e gruas në çdo fushë të jetës. Ai i thoshte burrave: “Kush edukon dy vajza e ka siguruar parajsën e amshuar”. Kurse gruan e quante edukatoren e familjes, duke treguar që parajsa ndodhet nën këmbët e nënës.

Në kohën e Profetit Muhamed a.s., gratë u interesuan shumë në marrjen e njohurive, për këtë arsye shkuan te i Dërguari dhe kërkuan që edhe ato të jenë pjesë e këshillave dhe njohurive që predikon profeti a.s. dhe ai për arsimimin e tyre, i hapi të gjitha dyert. Madje Ai përcaktoi një ditë në javë ku edhe vetë do të zhvillonte bashkëbisedime enkas e vetëm për gratë.

Njëra prej grave që i jepte shumë rëndësi diturisë, ishte edhe bashkëshortja e Profetit, Aishja. Nëna e besimtarëve, Aishja, r.a., ishte kureshtarë dhe e etur për dituri. Sa herë që dëgjonte diçka të cilën nuk e dinte, ajo pyeste derisa e kuptonte atë. Kështu prania e saj afër të Dërguarit të Allahut a.s, e bëri atë të ishte burim i pashteruar diturie.

Dituria dhe të kuptuarit thellë të saj nuk ishin të kufizuara vetëm mbi çështjet fetare, ajo gjithashtu ishte e shquar në poezi, letërsi, histori, mjekësi si dhe në shkencë të tjera të cilat ishin të njohura në atë kohë. Urve ibn El-Zubeir transmeton: “Nuk kam parë kurrë njëri më të mençur në fikh, në mjekësi apo poezi se Hz. Aishe.

Nuk kishte asnjë çështje me zgjidhje të vështirë, për të cilën Hz. Aishe të mos kishte njohuri. Gjithashtu dimë se

H. Aishe ka transmetuar 2230 hadithe (këshilla profetike) nga Pejgamberi a.s. Madje i Dërguari për të do të thoshte: “Gjysmën e fesë keni për ta mësuar prej Aishes.”

H. Omer, në periudhën e kryesimit të vet, një ditë, tek kish hipur në vendin e predikimit të të Dërguarit të Allahut, i kishte këshilluar myslimanët që në martesë të mos u jepnin grave një garanci kurore të madhe. Nga radhët e grave ishte ngritur një zonjë dhe i kish thënë: “Ej, Omer nuk ke të drejtë të thuash kështu!” duke i pasuar dhe vërtetuar fjalët e saj me ajete kuranore.

Më pas Hz. Omer thotë: “Allah Allah! Një grua bën debat me Omerin dhe ia mbyll gojën”.

Vetëm brenda 5 shekujve të parë të historisë së Islamit, numri i grave që u morën me tregimin e haditheve dhe me mësimin e tyre qe mbi 350.

Arsimimi i gruas është jetik për shoqërinë tonë, pasi është ajo që prodhon anëtarë të mirë ose të këqij të shoqërisë. Gruaja është shkolla fillore për fëmijët tanë. Ata ushqehet me moralin, vetitë dhe virtytet e larta pikërisht në prehrin e nënës. Që nëna mund t’i japë fëmijës një arsim të shkëlqyer për një kohë të gjatë në periudhën e rritjes, është kusht arsimimi i saj, njohja dhe përgatitja praktike mësimore dhe moral-etike e saj.

Përveç kësaj, arsimimi i gruas merr një rëndësi të veçantë edhe në ruajtjen e ekuilibrit të marrëdhënieve shembullore bashkëshortore. Një grua e arsimuar krijon harmoni familjare, krijon marrëveshje të mira me burrin dhe arrin deri aty që është përkrah tij në çdo veprimtari jetësore. Pejgamberi ynë thoshte kështu për Hatixhenë: “Beto hem se Allahu nuk më dha mua një grua më të mirë se Hatixhenë”.

Ajo më besoi kur njerëzit s’më besonin, ajo më dha të drejtë kur çdokush më përgënjeshtroi, ajo më ndihmoi materialisht kur çdokush më braktiste. Më tej Hz. Muhamedi, paqja qoftë mbi të, vazhdon: “Edhe sikur mua të më falnin gjithë botën dhe pasurinë e saj, për mua asgjë nuk është më e vlefshme sesa Hatixheja”. Kjo, sepse Ai e njohu shumë nga afër atë, në rrethana shumë të ndryshme, ndonëse edhe në moshë shumë të re, ai arriti të vlerësoi shumë virtyte të saj.

Nuk ka asnjë ajet në Kur’an apo thënie profetike që ndalon kategorikisht arsimimin e femrave, por fatkeqësisht shpeshherë dëgjohen zëra kundër arsimit të femrave. Kjo nuk vjen prej Islamit por prej mungesës së informacionit që përcjell Islami. Siç u përmend edhe më lart, feja Islame i ka ardhur në ndihmë gruas duke e ngritur dhe lartësuar pozicionin e saj.

Islami i nxit gratë që përveç mësimave fetare të mund të vazhdojnë studimet e larta, mund të fitojnë grada shkencore dhe të diplomohen si studiuese apo mësuese. Me pak fjalë, sipas fesë Islame, dyert e diturisë janë të hapura për gruan myslimane dhe ajo mund të hyjë në çdonjërin që dëshiron.

1. (Kur’an, Zumer, 39/9)

ÇFARË JANË PARAGJYKIMET FETARE

Paragjykimet fetare janë vlerësime negative apo pozitive për besimtarët apo ritet e një feje të caktuar, të bazuara kryesisht në përvoja të rastësishme të kontakteve me këtë fe, për të cilën nuk merret informacion i plotë ose merret informacion i gabuar, duke mos i marrë parasysh karakteristikat thelbësore të kësaj feje.

Ja një shembull paragjykimesh negative:

Fakti i të qenët p.sh. budist, të krijon një përshtypje, e cila më pas kthehet në paragjykim, sepse ti sjell ndërmend se kush janë pasuesit e kësaj kulture religjioze. Ata janë kinezë dhe indianë, shumica e të cilëve janë të varfër, skeptikë, të veçuar në tempujt e tyre duke adhuruar idhujt pa u kushtuar shumë rëndësi problemeve politike, etj.

Në formimin e kësaj ideje për të (budistin) nuk nisemi aspak nga njohja e fesë budiste. Për këtë fe, e aq më pak për personin në fjalë, ne kemi pak informacion ose edhe këtë informacion e kemi të pasaktë, por megjithatë... paragjykimin e krijojmë.

Të njëjtën gjë mund të themi për paragjykimet pozitive. Të marrim shembullin e një sekti të përhapur masivisht në Amerikë. Menjëherë na krijohet një paragjykim pozitiv duke u nisur nga fakti se këtë sekt e kanë përqaftuar shumë amerikanë dhe se amerikanët janë të përparuar, të pasur, kanë kulturë, etj. Ne nuk nisemi aspak nga fakti se çfarë është ky sekt, duke mos ditur asgjë për të (ose gjëra të gabuara), por paragjykimin e formojmë.

Këtu del edhe një problem tjetër, ai i identifikimit të fesë me anë të personit. Kjo nuk është aspak e drejtë, sepse me këtë gjë abuzohet, duke iu krijuar të tjerëve paragjykimet negative ose pozitive për një fe të caktuar. I tillë është rasti kur një person thotë se jam mysliman apo katolik dhe vepron diçka që është në kundërshtim me parimet e fesë që ai ndjek, atëherë nuk kemi pse të krijojmë paragjykimet negative për këto fe. Formimi i paragjykimeve, duke u nisur nga individët përkatës, nuk është i drejtë, sepse jo kushdo është në gjendje t'i prezantojë me përpikëri parimet e fesë së tij. Në këtë rast formohen paragjykimet të gabuara për një fe të caktuar, duke u nisur nga prezantimi jo i saktë që ky individ i ka bërë fesë së tij, qoftë kjo edhe pa qëllim të keq. Edhe nëse një person që ka krijuar paragjykim pozitiv ose negativ për një fe të caktuar, përballet me realitetin e kësaj feje, ai reagon gjithmonë në përshtatje me paragjykimin e parë, duke e injoruar realitetin ose duke mos e përfshirë këtë informacion të ri në mendimin e krijuar për këtë fe.

Duhet të kemi parasysh se paragjykimet fetare nuk mund të merren si të ndara nga llojet e tjera të paragjykimeve e sidomos nga ato raciale. Kjo

ndodh se nuk mund të bëhet një dallim thelbësor në mes individit të një kombi, që identifkohet me një fe të caktuar, dhe individit që mund të jetë anëtar i fesë, por jo i atij kombi. Ndërsa në rastet kur brenda një kombi, me fe të ndryshme, ka paragjykimet fetare dhe kur këto bëhen aktive, atëherë kemi të bëjmë me diskriminim fetar.

Nuk është e thënë që grupi i paragjykuar duhet të jetë patjetër më i vogël në numër që të pësojë diskriminim, por mjafton që paragjykuesit të kenë pushtet mbi të paragjykuarit edhe nëse janë më të paktë në numër.

Shkaqet e lindjes së paragjykimeve fetare

- Ndër shkaqet kryesore të paragjykimeve për fetë ka qenë abuzimi i klerikëve nën petkun e prijësit shpirtëror, sidomos gjatë periudhës së mesjetës në Evropë. Njerëzit e fesë, duke pretenduar se ushtronin autoritetin e Zotit, arritën deri në shkallën e skllavërimit të njerëzve. Sipas tyre, njerëzit e thjeshtë ishin të paafhtë për t'u lidhur direkt me Zotin; këtë të drejtë e kishte vetëm kleri nga i cili, për më tepër, dokumentohen edhe probleme me moralin e mospërputhje e veprës me fjalën.

Një situatë e tillë nuk kishte se si të mos krijonte paragjykimet negative për fetë, të cilat prezantohen nga klerikë të tillë. Për këtë çështje Frojdi, në teorinë e tij, thotë se: "Pas shprehjes së paragjykimeve fshihen konfliktet dhe mospërshtatjet psikologjike". Nga kjo thënie kuptojmë se kur njerëzit janë acaruar dhe janë të paafhtë t'i rregullojnë problemet e tyre, shpesh ata e kthejnë krahun e goditjes drejt burimit të acarimit, e në rastin tonë drejt klerikëve, e më pas, fatkeqësisht, edhe ndaj vetë fesë. Paragjykimi arriti kulmin kur elementet përparimtare filluan prezantimin e zbulimeve të tyre, që i kushtoi jetën dikujt duke u djegur në turrën e druve nga ata që "zotëronin" "Dijen Absolute". Këto veprime e të tjera si këto, në Evropë dhe në vende të tjera ku probleme të tilla ishin të dukshme, shkaktuan urrejtjen dhe zgjimin e vetëdijes antifetare te njerëzit, të cilët filluan ta braktisin fenë. Jo vetëm kaq, por ata njerëz tashmë bartnin dhe ndjenjën e urrejtjes për çdo fe pa pasur kurrfarë dije për të; mjafton të ishte fe dhe njerëzit e urrenin. Ky është shkaku kryesor i krijimit të përshtypjeve negative për fetë në përgjithësi. Kjo ka qenë një periudhë e vështirë për Evropën e asaj kohe, fundi i së cilës shënoi dhe ndarjen e fesë nga shteti, e cila pak nga pak u kthye në ndarje të fesë nga jeta e përditshme, deri në degradimin e saj në një takim të fundjavës.

Ky shkak i lindjes së paragjykimeve ka zënë fill në atë kohë, por vazhdon edhe sot e kësaj dite

në çdo vend ku klerikët apo prijësit fetarë abuzojnë me fenë e tyre.

- Paragjykimet, siç përmendet dhe në përkufizim, formohen nga informacioni i kufizuar ose i gabuar për një fe të caktuar dhe, rrjedhimisht, edhe për personin që e ndjek këtë fe. Me mënyrën e parë krijohet paragjykimi duke u nisur nga qëndrimet e sipërfaqshme e subjektive. Këto u ofrohen njerëzve përgjithësisht me anë të kulturës popullore (artit të konsumit apo masmedias, etj.) poseduesit e mjeteve të tilla, duke e kuptuar rëndësinë për të ndikuar në trurin e njeriut dhe për të futur në të mesazhin e duhur, i shfrytëzojnë ato për të krijuar paragjykime për fetë, ose besimtarët e një feje të caktuar. Kështu, për shembull, nëse dëgjon fjalën "prift", menjëherë të vjen ndër mend një asket, i cili veçohet nga njerëzit në vetmi të plotë, duke mos u martuar kurrë. Edhe nëse kjo mund të jetë reale, për një pjesë të klerikëve, paragjykimi i tillë formohet, bazuar në opinionin e ofruar prej kulturës popullore, filmave etj., apo duke u nisur nga filmat, artikujt e shumtë dhe librat e botuar, që flasin për terrorizëm islamik, menjëherë na krijohet imazhi se myslimani nuk mund ta konceptojë jetën e tij pa luftë, pa vënë ndonjë bombë, pa prerë e masakruar. Na shkon ndërmend një mysliman

me mjekër të zezë e çallmë të bardhë, i cili mban në njërën dorë automatikun e në tjetrën bombën. Ky imazh arrin deri atje saqë sa herë flitet për vrasje, shpërthim bombe, masakrim njerëzish të pafajshëm etj., menjëherë na krijohet përshkrimi i lartpërmendur, i ilustruar më mirë nga personi i Bin Ladenit.

Paragjykimet e lindura nga ky burim (ai i informacionit të mangët ose të gabuar) i prekin të gjitha besimet edhe pse për njërin krijohen paragjykime pozitive e për tjetrin negative, në varësi të atij që i disponon këto mjete. Formimi i pjesshëm i disa njerëzve shkon deri aty sa mjafton që të lexojnë apo dëgjojnë diçka dhe menjëherë i krijojnë skemat e tyre, duke i mbushur me paragjykime të ndryshme, pozitive apo negative qofshin, të vërteta apo të gabuara; duke e justifikuar veten se, sikur të mos ishte e vërtetë nuk do të shkruhej në gazetë apo flitej në radio...

Këto ishin dy rrugët kryesore të krijimit të paragjykimeve për fe apo fetarë të ndryshëm. Ekzistojnë edhe shkaqe të tjera me ndikim më të vogël siç është mospasja kontakt dhe ndërveprim mes individëve të feve të ndryshme, apo mosvendosja në status të përbashkët të tyre, ku kriter të mos jetë feja, por aftësia e individit dhe se sa i përgjigjet ai këtij apo atij statusi. Duke u nisur nga fakti se

formimi i paragjykimeve fillon që në moshë të vogël, prindërit përpiqen t'u japin fëmijëve ato gjëra që dëshirojnë e, në njëfarë mënyre, fëmija do të ushqehet me atë frymë derisa të arrijë të kuptojë realitetin me veprat e tij. Në këtë pikë bën pjesë edhe formimi i paragjykimeve të fëmijët me anën e fjalëve dhe veprave të prindërve, duke u nisur nga fakti se fëmija, si një kasetë e paregjistruar, regjistron çfarë sheh dhe dëgjon. Është me rëndësi të përmendim se njerëzit me arsim të ulët janë më paragjykses e të prirur të njësojnë fenë me dukuri që s'kanë lidhje.

Paragjykimet fetare në Shqipëri pas viteve '90

Pas lejimit të pluralizmit dhe lirisë fetare, paragjykimet fetare nxorën kokë furishëm. Ardhja e shumë misionarëve nga vende të ndryshme, për thirrje fetare, u shoqërua edhe me lindje paragjykimesh të reja mbi ato ekzistueset. Këto paragjykime e kanë burimin në ballafaqimin me njerëz të kulturave të tjera, të cilat, mentaliteti i ngurtësuar prej dekadash izolimi, shpesh i keqkuptoi, duke i ngatërruar nënshtrësas kulturore me thelbin fetar të personi i misionarit të huaj, shpesh në dëm të fesë. Kontributin e vet shembullor, sidomos në krijimin e paragjykimeve anti-islame, e dha shtypi, me tituj bombastikë

të tipit "Islamik, bombë në kryeqytet", "Myslimanët shqiptarë janë pasardhës të haremeve turke", "Allahu shkatërroi kishat", etj. Është për t'u vlerësuar fakti se këto "zhurma" lindin dhe përfundojnë po në gazeta, por jo pa lënë efekte të konsiderueshme në imagjinatën kolektive, duke u bërë ushqim për paragjykimet. Edhe pse është shumë e vështirë të maten paragjykimet fetare, të cilat nuk janë vlera konkrete, mund të themi se janë krijuar gjeneratorët për prodhimin e tyre nga ana e mediave dhe institucioneve kulturore, monopol i një elite të deformuar, agresive ndaj shenjtërisë dhe religjiozitetit në përgjithësi e ndaj Islamit në veçanti.

Por ndikimi i tyre në krijimin e një shtrese shoqërore homogjene paragjyksesish është ende në fazat fillestare, pasi edhe të prekurit nga kjo strategji (besimtarët) po i shmangen një përplasjeje të hapur me gjeneruesit e këtyre paragjykimeve.

Po nuk iu kundërvumë në kohë këtij virusi, epidemia e paragjykimeve mund të prodhojë turma "të satanizuara" si ato të fundit të viteve '60, që rrënuan faltoret dhe shkulën fenë nga shoqëria. Betejat e së nesërme fitohen sot.

Gazmend Leçini

Suneti i pastër i Muhamedit a.s. **burim i pastër për arsimin, kulturën dhe civilizimin islam**

Në historinë e kulturës dhe shkencës islame në Shqipëri, dallohet studiuesi dhe mësuesi H. Ibrahim Dalliu, i cili me botimet origjinale teologjike e publicistike si dhe në fushën e përkthimeve, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm me vlera shpirtërore për myslimanët shqiptarë. Një nga përkthimet më të rëndësishme të botuar në vitin 1936 titullohet "Udha Muhamedane". Ky libër me autor Imam Bergeriun (1522-1599), ka vlera të mëdha sepse është një nga veprat bazë ku merren shpjegime për çështje të moralit, kulturës dhe jurisprudencës islame. H. Dalliu në parathënien e librit shprehet: "E përktheva këtë libër, që të përfitojnë shqiptarët musliman nga ai ose më mirë të themi: të mësojnë se çfarë sendesh janë të ndaluara nga ana e Zotit dhe e profetit të tij, dhe me çfarë detyrash janë të urdhëruar fetarisht

ata." Më poshtë shprehet: "Edhe me qenë se ka krizë financiare do t'i japim pa para". Ishte pikërisht Hafiz Dalliu i cili kontribuoi e sakrifikoi për myslimanët shqiptarë dhe njëkohësisht si patriot atdhetar që ishte, u persekutua e u burgos disa herë. Myslimanët shqiptarë duhet ta studiojnë këtë libër sepse bën fjalë për rrugën që duhet të ndjekin në të kuptuarit e Sunetit të Muhamedit (a.s.), në rregullat e saktësimit të teksteve të hadithit dhe çështje të tjera, që ndihmojnë për arsimin, për të fituar kulturë të gjerë shkencore, që të çon drejt civilizimit islam.

Në këtë mënyrë do të vihet feja Islame në vendin që meriton, si paraprijëse e të gjithë niveleve kulturore e civilizuese, e jo të reduktohet vetëm në sjellje personale të çdo besimtar, ose në disa aspekte formale të jashtme, që nuk bëhen pjesë e



shoqërisë dhe që nuk krijon unitet për të ndihmuar në civilizimin e saj. Islami është themeli i jetës dhe e obligon çdo besimtar t'i përmbahet Librit të Allahut dhe Sunetit të Dërguarit, Muhamedit (a.s.). Prandaj dhe H. Dalliu e vë theksin në këtë libër që t'i kthehemi Islamit të plotë, besimit të tij, ligjit, adhurimit, moralit, marrëdhënieve ndërnjerëzore sipas parimeve të tij. Në kapitujt që përmban libri kuptojmë që Islami për besimtarët e tij është program jete dhe e rregullon atë në të gjitha fushat e saj. Por që të realizohet kjo, kërkon si domosdoshmëri që t'i paraprijë besimi i sigurtë në Zotin e Amshuar. Ky besim bën baraspeshën midis mendjes dhe zemrës, bashkon shpirtin me trupin, idealen me realen, individin me shoqërinë mes të drejtës personale dhe interesit shoqëror. Atëherë do të kemi një njeri të mirë,

familje të shëndoshë e për rrjedhojë një shoqëri pa fenomene negative. Zoti në Kur'an na porositi: "Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata të ndryshojnë veten e tyre" (Rad, 11). Prandaj, në qoftë se dëshirojmë një shoqëri të shëndoshë me virtyte e morale të ndershme t'i mbështetemi besimit, sepse ai i jep energji personalitetit, krijon një ndërgjegje të pastër, formon qytetarin e denjë për një shoqëri që sheh përpara drejt civilizimit të saj.

Mirëpo myslimanët sot ushqehen me mësim të historisë islame të trashëguara me karakteristikat e saj sipas etapave të ndryshme si dhe me kulturën fetare të importuar, të përkthyer ose jo. Përballë këtyre dy kulturave të pakontrolluara, pa u bazuar në traditën dhe historinë dhe kulturën e popullit shqiptar e teologëve të tij, besimtari i paarsimuar

mbetet i çoroditur, ndërsa intelektual i mysliman bashkëkohor si konsumues i kësaj kulture, është i paaftë për të vepruar, për të prodhuar kulturë e për të orientuar në vlerat e qytetërimit islam. Intelektuali islam dhe teologët e mirëfilltë duhet të japin një vizion më të qartë gjithë kërkesave të kësaj periudhe dhe të bëhen të vëmendshëm në interpretimin e burimeve të sakta të Islamit, Kur'anit dhe Hadithit, ashtu siç shprehet Hafiz Dalliu: "Thoni se arsyt mendore dhe argumentet tradicionale fetare janë të bashkuara në Librin e shenjtë, Kuranin dhe fjalët e madhërueshme të Pejgamberit a.s."

Prandaj këto burime duhet të studiohen e të kuptohen drejt nga një këndvështrim bashkëkohor, për të sqaruar rregullat e përgjithshme të Islamit dhe për të vendosur programin e domosdoshëm, me qëllim që Islami t'i përgjigjet sfidave të kohës. Intelektualët teologë bashkëkohës të H. Ibrahim Dalliu u mbështetën në Kur'anin e Madhëruar dhe Sunetin e Profetit (a.s.), në studimin e tyre me metoda origjinale. Kjo u dha mundësi t'i kuptojnë e transmetojnë drejtë te besimtarët myslimanë, të bëjnë analiza me realitetin dhe ligjet dhe t'i integrojnë ato në shoqëri, për të mbrojtur gjuhën, traditën, fenë dhe atdheun. H. Ibrahim Dalliu që përktheu nga origjinali veprën "Udha Muhamedane", flet në praktikë për ndjekjen e rrugës së Muhamedit, për biografinë dhe mënyrën e jetesës së tij dhe të jetesës si pejgamber. Ky studim pasqyron mishërimin shkencor dhe aktual të metodës që duhet ndjekur. Prandaj dhe Dalliu në këtë vepër shprehet: "Nuk bëhet ndryshe veçse me ndjekjen e vulës së profetëve, profetit të fundit, Muhamedit, që është i madhi ynë dhe i madhi i të parëve e të mbrapmëve në besim, në fjalë, në moral dhe në vepra". Në këtë mënyrë vjen të kuptuarit e qartë të Sunetit, njohja e qëllimeve dhe e synimeve praktike të tij, duke bërë të mundur që të zhduket injoranca, të mënjanohen konfliktet dhe të bëhet faktor i dobishëm në shoqëri. Kjo tregon se nuk mjafton vetëm kuptimi i jashtëm formal i udhës së Profetit (a.s.), por më shumë ka rëndësi të kapurit pas brendësisë, shpirtit të tij, duke shmangur deformimet e atyre që hiqen si të ditur. Për këtë dijetari bashkëkohor, doktor Jusuf Kardavi në veprën e tij "Si të bashkëveprojmë me Sunetin", shprehet: "Ka disa neglizhues, të cilët duan të hyjnë dhe flasin për Allahun e Pejgamberin e Tij atë që nuk e dinë..." Nga kjo thënie kuptohet se duhet ta ruajmë të pastër hadithin e Profetit

(a.s.), të mos i zmadhojmë gjërat e as të mos i deformatojmë ato gjoja në emër të ndjekjes së rrugës së tij.

Dihet që Suneti i Muhamedit (a.s.) është interpretimi praktik i Kur'anit dhe zbatimi real i Islamit. Zoti në Kur'an thotë: "Me të vërtetë juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe një libër i qartë (Kur'ani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij në udhën e shpëtimit, i nxjerr ata prej errësirës në dritë, me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në udhën e drejtë..." (Maide, 15-16). Këtë udhë të drejtë e praktikoi dhe e ndoqi me saktësi Muhamedi (a.s.) dhe prandaj vepra titullohet "Udha Muhamedane". Kjo udhë përbën Sunetin e tij, që përmbledh tërë jetën e njeriut, që nga lindja e deri në vdekje dhe më tej, që nga krijimi i embrionit deri pas vdekjes. Me një fjalë përfshin të gjitha fushat e jetës individuale, familjare e shoqërore si dhe lidhjen e ngushtë me Zotin e tij jo vetëm në këtë botë, por edhe në botën tjetër. Pra, për të njohur Islamin praktik me bazat e tij, duhet mësuar e ndjekur Suneti i Pejgamberit (a.s.), për të cilin Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Ai që i bindet të dërguarit të Allahut, i është bindur edhe Allahut" (Nisa, 80). Prandaj dhe autori për të ndihmuar besimtarët që të përsosin moralin e tyre duke ndjekur si shembull H. Muhamedin, botoi këtë libër me rëndësi moralo-shpirtërore e jetike. Bashkëshortja e Pejgamberit (a.s.), Aishja r.a. thotë: "Moral i tij ishte Kur'ani." Kjo do të thotë se Suneti i Pejgamberit (a.s.) është rruga apo udha që duhet të ndjekë çdo mysliman sepse përfaqëson Kur'anin e interpretuar dhe Islamin e vërtetë në praktikë, në punë, në fjalë dhe gjithë jetën e çdo besimtar, në atë individuale e shoqërore, me farefisnin e më gjerë, në çdo rrethanë e moment të jetës, pa u shkëputur nga lidhja me Zotin e madhëruar. Kjo e detyron besimtarin që të kuptojë mirë udhën jetësore që përshkoi Muhamedi (a.s.) për të qenë korrekt me ligjet juridike, morale, edukative, si individ, në familje dhe shoqëri.

Gjatë komentit të veprës "Udha Muhamedane", nuk kemi për qëllim të ndalemi thjesht në ajete dhe hadithe që sillen në kapituj të veçantë. Qëllimi është të kuptojmë të vërtetën, Islamin në tërësi të mishëruar në jetën e Muhamedit (a.s.), të njohim personalitetin e tij përmes jetës dhe veprës; të krijojmë bindjen se nuk ka qenë vetëm gjeni, që shquhesh në mesin e popullit, por, para së gjithash, ai ka qenë i dërguari i Zotit me shpallje, që nëpërmjet saj krijoi kushtetutën, bëri shtet e perandori dhe të

gjithë iu përmbajtën rrugës së tij.

Autori përmes kësaj vepre na lejon të kuptojmë se me studimin e saj pasurohemi më shumë me kulturë islame si në fushën e besimit, ligjit apo moralit, sepse jeta e Pejgamberit (a.s.) është objekti i ndriçuar në të cilin janë skalitur ligjet e besimit islam. Hadithet që sillen në këtë libër na ndihmojnë për zgjidhjen e shumë problemeve dhe gjetjen e rrugëve më të drejta, për çdo gjë që ka të bëjë me jetën, me punën, familjen, ushqimin, veshjen, marrëdhëniet me njerëzit e deri me kafshët.

Të ndjekim udhën e H. Muhamedit (a.s.) sepse natyra dhe karakteri i tij janë aq të pastra, sa që ai në çdo çështje është i vërtetë, i drejtpërdrejtë dhe fisnik. Ai gjithmonë ka frymëzuar virtyte të larta e drejtësi, dhe i zbatonte vetë e pastaj i predikonte te të tjerët. Gjithë jeta e tij është në harmoni me Islamin. As fjala, as vepra nuk janë nxitur nga interesi personal. Ai ka vuajtur për të mirën e të tjerëve, por asnjëherë nuk i ka bërë të tjerë të vuajnë për të. Jeta e tij është shembull i fisnikërisë së vërtetë, pastërtisë së mendjes së ndritur e të lartë. Muhamedi (a.s.) është forma më e lartësuar e qenie njerëzore, karakteri i tij është pa të meta. Si i dërguar i Allahut duhet ndjekur udha e tij, fjalët e tij duhen pranuar, udhëzimeve dhe urdhrave të tij duhet t'i bindemi. Mosbindja ndaj tij është mosbindje ndaj Allahut, dhe kjo patjetër të çon në degjenerim e shkatërrim. Është për t'u çuditur se shumë njerëz me emrin besimtar pranojnë vërtetësinë e Profetit, por nga ana tjetër nuk ndjekin rrugën e tij në problemet e jetës. Shpesh mohimi i së vërtetës nga secili është si rezultat i injorancës apo arrogancës së tij si dhe të paragjyqimeve që ai lëshon.

Në këtë libër autori vë theksin se profeti Muhamed është i dërguari i Zotit, për të përçuar te njerëzit mesazhin e tij. Është urdhri i Allahut që njerëzit të besojnë dhe të ndjekin të dërguarin e Tij. Ashtu siç thuhet në Kur'an: "Ne i dërguam të dërguarit tanë me dëshmi të qarta dhe Ne zbritëm me ata, librin dhe drejtësinë, që njerëzit t'i përmbahen të drejtës." (Hadid, 25). Nga ajeti kuptohet se detyra e njeriut është të pranojë Profetin dhe të ndjekë gjurmët e tij. Kjo është rruga drejt shpëtimit sepse jeta e tij paraqet veprën praktike, e cila trupëzoi realitetin e plotë islam, personalitetin e tij më të lartë në çdo sferë të jetës, në mënyrë më të plotë dhe më të qartë. Prandaj dhe Zoti u drejtohet njerëzve me këto fjalë në Kur'an: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut" (Ahzab, 20).

Suneti i Pejgamberit (a.s.) jo vetëm shpjegon Kur'anin, por nuk ndahet prej tij, e prandaj ai është burimi i ligjeve islame si adhurimi, marrëdhëniet mes njëri-tjetrit, me familjen, shoqërinë e shtetin. Ai sjell argumente të qarta me fjali kuptimplote për urtësi në sjellje, jep këshilla prekëse, tregime edukative, reflektim të urdhrave e ndalesave, nxitjes dhe frikësimit, gjëra të cilat zbusin zemrat e ngurta, lëvizin synimet e heshtura etj. Autori në "Udha Muhamedane" sjellje argumente që H. Muhamedi ndjek të njëjtën rrugë në të komunikuar në secilin si një tërësi, bashkon mendjen dhe zemrën, duke punuar për të formuar personalitetin e plotë të besimtarit, me mendje të lartë, zemër të pastër e trup të shëndetshëm. Në këtë libër që përfshin Sunetin e Profetit (a.s.), për secilin ka një kapital të pashtershëm për ta udhëhequr atë në punë të mbara dhe të mira të dobishme për jetën e tij.

Që ta kuptojmë drejt Sunetin, autori gjithnjë ka sjellë argumente e përshtatje me Kur'anin, ashtu siç sjell ajetin 115 të sures "En'am" ku Allahu thotë: "Fjalët e Zotit tënd janë të vërteta dhe plot të drejta, nuk ka kush të drejtë të ndryshojë fjalët e Tij. Ai është që dëgjon e di." Me këtë ajet vërtetohet se Kur'ani është shpirti i ekzistencës së Islamit dhe themeli bazë i tij, është në rolin e kushtetues origjinale, ku të gjitha ligjet kanë origjinën e tyre. Profeti Muhamed është shpjegues i kësaj kushtetute, sqarues i saj dhe në të njëjtën kohë ai e praktikoi për njerëzit që të ndjekin rrugën e tij. Interpretimi i Kur'anit, çiltërsia në të cilin e paraqiti Pejgamberi (a.s.) dhe pas tij saktësia e Sunetit apo udha e tij përbëjnë ligjet e Islamit, për një kulturë të gjerë e civilizim bashkëkohor, të cilët ia rrisin besimin në vetvete secilit besimtar.

Nëpërmjet librit "Udha Muhamedane" ne arrijmë të njihemi me poseduesin e moralit më të lartë, thirrësin e mëshirshëm, bashkëshortin ideal, edukatorin e njerëzve me anë të konsultimeve, mëshiruesin për besimtarët, të kujdesshmin ndaj të gjithëve dhe bartësin e flamurit islam. Ai ishte politikan me vizion të qartë, udhëheqës ushtarak i zoti, por ishte dhe prind i dashur e i butë, i afërt me familjen e tij dhe shok besnik; ndihmonte dhe jepte nga dashuria dhe butësia e tij, nxitës për arsimin dhe kulturën. Ky është morali shembullor, që duhet të përftojë çdo besimtar e të ndjekë udhën e tij dhe mbi bazën e këtyre vlerave të ndërtojë jetën individuale e familjare në shoqërinë e tij.

Zemra jote, si toka e përhumbur

Njerëzit flasin shpesh rreth përhumbsjes (përkushtimit). Shpesh na rastis që ta dëgjojmë si fjalë dhe të thuhet se filani është i përhumbur (i përkushtuar), kurse ai tjetri nuk është i përhumbur dhe në të shumtën e rasteve, shohim që ata përshkruajnë gjendjen e përhumbsjes ose rrugët që të çojnë drejt saj, por nuk i japin një përkufizim vetë thelbit të përhumbsjes.

Atëherë, çfarë është përhumbsja?

Po të vërejmë shumicën e atyre që flasin për përhumbsjen, gjejmë se ata i qasen asaj vetëm nga një këndvështrim, vetëm nga një dimension, i cili përmbledhet tek e qara, nënshtrimi dhe përlësia, të cilat kanë si pasojë lotët e syrit.

Në fakt, përkushtimi dhe përhumbsja e vërtetë është shumë herë më e madhe sesa pasojat e lartpërmendura, pasi përfshin shumë dimensione të tjera më rrezatuese, të cilat i japin kuptim real dhe efekt praktik.

Përhumbsja e vërtetë është ajo gatishmëri për të marrë dhe kapur "fjalën e rëndë", është gatishmëri për të dalë nga errësirat në dritë, gatishmëri për ndryshim të vetes dhe ndryshim të botës më pas, falë ndërveprimit me Kur'anin dhe namazin. Në fund, është gatishmëria për të ndërvepruar me diskursin e Kur'anit, gjë e cila është në nivel zemre fillimisht, pastaj kalon edhe në nivel

gjymtyrësh.

Për shkak dhe si pasojë e mallit të zemrës për përkujtimin e Zotit, me Kur'an apo namaz, njeriu përhumbs në përgjërime për Krijuesin.

Kjo përhumbsje është aparenciale dhe e dukshme në përlësinë e zemrës dhe modestinë e saj para Kujdestarit të botëve, para Nurit të Tij të qartë. Menjëherë pas kësaj gjendjeje, kjo zemër, brof dhe mbushet me energji për jetën që e pret.

Pas një periudhe të plogësht, zemra e tij lulëzon, mbushet me gjelbërim. Ajo i ngjan tokës së përhumbur, e cila mezi pret erërat e ndryshimit dhe është duke u përgatitur për ndryshimin. E kur Zoti të lëshojë shiun, ajo shkundet dhe fillon të lulëzojë. Ai që e ngjalli tokën, do i ngjallë dhe të vdekurit, Ai është i aftë për gjithçka.

Po, do të shkundet dhe do të brofë zemra e tij, pasi fjalët që përmend janë të rënda, sepse i rëndë është amaneti që i është besuar nga Zoti i botëve. Pas kësaj, fjalët do të ndërveprojnë, do të lulëzojnë në zemër dhe fryti do të duket në jetën e re. Bima e re do të zhvillohet dhe lulëzojë, sa më shumë të zhvillohet dhe lulëzojë ndërveprimi me fjalët e Zotit. Ai që e ngjalli tokën, do i ngjallë dhe të vdekurit, Ai është i aftë për gjithçka.

Po, Ai është i aftë ta ngjallë zemrën tënde nga vdekja,



por gjithmonë me një kusht; gatishmërinë e saj për t'u ngjallur. Vetëm kështu mund të ngjallet dhe të lulëzojë jeta e vërtetë e kësaj bote.

Vetëm atëherë do të ndodhë ajo shkundja e madhe, fillimi i të cilës është në nivel zemre. Ajo do të përshkojë trupin, duke e bërë të brofë dhe të ringjallet pas vdekjes. Për shkak të shkundjes së madhe, do të rrëqethet lëkura e njeriut sa herë që lexon shenjat (ajetet) e të Gjithëmëshirshmit, nga fjalët e të cilit rrëqethen zemrat e atyre që e duan. Mandej, zemrat dhe lëkurat e tyre zbuten dhe qetësohen para përkujtimit të Zotit.

Nuk ka matës që mund ta masë forcën e kësaj lëkundjeje dhe shkundjeje, as "rihter" dhe as ndonjë tjetër. Matësi i vetëm i saj është realiteti që do të ndryshojë ky njeri, të cilin Zoti e ringjalli nga e para.

Si pasojë e fuqisë së fjalëve hyjnore të cilat e shkundën zemrën, vjen dhe e qara e vërtetë për shkak të dhimbjes së madhe. Pas saj, njeriu shpejton të kthehet tek Zoti i tij dhe të bëhet gati për të marrë dhe prituri fjalët e Tij. Kjo është pasoja e parë e përhumbjes. "Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimin. Sigurisht, Ai i pranon shumë pendimet, Ai është Mëshirëploti." (Bekare, 37)

Pas kësaj, ndodh shkulla nga rrënjët e çdo bime të

keqe dhe të prishur, për t'i krijuar hapësira bimës së re. Kështu njeriut i mundësohet një lindje e re, një krijim i ri. Zoti është Krijuesi më i mirë.

Si pasojë e përhumbjes së zemrës, përhumben edhe gjymtyrët e tjera, përhumbet syri, veshi dhe i gjithë trupi. Përhumbja thellohet më shumë sa më i lartë të jetë ndërveprimi i fjalëve me zemrën. E nëse njeriu përhumbet në këtë mënyrë, ndërveprimi i tij me natyrën do të jetë më i madh.

Zemra e përhumbur është baza e gatishmërisë, pikënisje e shkundjes dhe e rilindjes, katalizator i suksesit dhe i aktivitetit në jetë. Fatkeqësisht, në kemi pasur qasje negative karshi përhumbjes, ajo prodhoi gatishmëri për përlulje karshi Zotit, por nga ana tjetër prodhoi plogështi në jetë.

Vetëm me një zemër të përhumbur mund të kemi ndryshim, me kusht që të ketë gatishmërinë për të marrë dhe ndryshuar, për të dalë nga aktualiteti pasiv drejt një aktualiteti pozitiv më të mirë.

Nëse kjo zemër nuk është e gatshme për këtë, përhumbja e saj do të jetë naive, pa kuptim dhe pa objektiv, thjesht një shtirje, narkozë e vërtetë.

Ali Asakir

Familja në Islam

Në ditët e sotme, sikurse në shumë drejtime, fatkeqësisht, edhe në institucionin e familjes ka një ikje prej vetvetes, një ikje prej vlerave tona. Ndërkohë që në kohët kur gjithçka e jetonim sipas mënyrës sonë, nuk kishim ndonjë problem serioz në këtë çështje. Mirëpo më vonë, ndodhi si ndodhi dhe ne, duke i quajtur "zakone" vlerat që na përkisnin, i hoqëm ato pors i një rrobë e vjetër dhe i hodhëm mënjanë. Pikërisht pas kësaj, sikurse edhe në fusha të tjera, ndodhi që në institucionin e familjes filluan të shfaqen vështirësi serioze. Mund të thuhet se vijueshmëria e prehjes brenda familjes është e lidhur me një harmoni të plotë mes bashkëshortëve.

Fatekqësisht, sot myslimanët nuk i njohin në masën e duhur Islamin dhe parimet e tij themelore, që rregullojnë jetën tonë. Për më tepër që për ta ndier Islamin në kuptimin e tij të vërtetë, nuk mjaftojnë vetëm njohuritë doktrinare. Feja

duhet të bëhet jetë prej jetës dhe duke u jetuar, të kthehet në pjesë të karakterit. Por ja që duke qenë se Islami nuk njihet në thellësinë dhe në gjerësinë e tij dhe nuk jetohej një jetë e mbështetur në të, njerëzit nuk e dinë e as mund ta dinë se ç'vështirësish duhet t'u nënshtrohen në çështjet për të cilat kanë marrë përgjegjësi me vullnetin e tyre. Ta zëmë se në marrëdhëniet brenda familjes, njëri nga bashkëshortët ka një të metë, një dobësi. Kundrejt një problemi të tillë, individit duhet të pyesë veten: "Si mundem unë, vallë, ta largoj këtë të metë dhe me ç'mënyrë mund të çlirohem prej këtij problemi?" E në këtë pikë, duhet të hulumtojmë për urdhëresat, këshillat dhe porositë që jep feja. Por në këndvështrimin tim, nuk më duket se për këtë çështje ka ndonjë shtjellim serioz mendimi. Po. Fatkeqësisht, në ditët tona askush nuk mendon me seriozitet që të mësojë fenë e

vet. Sa njerëz prej nesh, vallë, ka që mund të dalin e të thonë, "Për të mësuar fenë time, e kam lexuar ilmihalin tri herë"?

Po. Fatkeqësisht, ne nuk i njohim vlerat tona themelore. Si rrjedhim i kësaj, një moral i huaj për vlerat tona ka ardhur e ka shtrirë sundimin në shpirtin tonë. Një herë e një kohë diskutohej në formën: "Nëse hyjmë në Bashkimin Evropian, a prishemi apo jo?" Por ndërkohë që merreshim me këso diskutimesh, ne paskëshim qenë prishur me kohë. Dhe në ditët e sotme, puna erdhi në një pikë të tillë që burra e gra bëjnë një jetë të lëshuar. Shtëpitë janë kthyer në mensa. Nëpër shtëpi, babai është në rolin e rojës, nëna në rolin e kuzhinieres dhe fëmijët në atë të njerëzve që ushqehen në mensë. Natyrisht që në një çerdhe të tillë nuk gjenden vlera shpirtërore si vetëdija e përgjegjësishë, e durimit, e përballimit, e pranimit të njëri-tjetrit, e të sakrifikuarit për njëri-tjetrin, e të jetuarit për njëri-tjetrin, si dhe dashuria, vlerësimi e respekti që lindin prej këtyre. Kur të gjitha këto nuk gjenden, në atë çerdhe nuk ka as prejhe të qëndrueshme e të përhershme.

Fëmijët e mbetur jetimë me prindërit gjallë:

Për këtë arsye, dua ta shpreh edhe një herë se një njeri duhet të jetë i pajisur me aftësi së paku në nivelin më minimal që t'i vërë në vend përgjegjësitë dhe detyrat që mbart martesë; nëse nuk është i pajisur kështu, atëherë nuk duhet të martohet. Në të kundërt, në institucionin e martesës ndodhin thyerje e krisje që në krye të herës. Sepse struktura, për më tepër, ngrihet mbi një themel që mund të thuhet lehtë. Në përfundim, gjithë ç'ndodh u ndodh fëmijëve dhe ata mbeten në mes të një dyzimi të thellë.

Si pasojë e kësaj, na shfaqen plot e plot fëmijë me nënë e babë, por që kanë mbetur në mes të një dyzimi të tillë, që i ka bërë t'i humbasin prindërit për së gjalli.

Kur dëgjoj për shqetësimet familjare, veçanërisht për lëndimin që pësojnë gratë, hidhërohem shumë. Në ditët tona, gruaja, për fat të keq, nga njëra anë synohet të kthehet në idhull prej një grupi feministësh dhe për pasojë, kjo e bën atë që të ndeshet me një numër handikapësh në kundërshtim me natyrën e saj. Nga ana tjetër, disa të tjerë sillen rëndë ndaj gruas; i kthejnë paditurinë, zbrazëtinë dhe dobësitë e veta në një mllëf e zemërim dhe ia zbrazin asaj.

Zotëria ynë, i Dërguari Fisnik (s.a.s.), në "Hutben e Lamtumirës", për bashkëshortet, urdhëron e thotë: "Ato janë amanet pranë jush." [280] Dhe çfarëdo lloj fjale e shëmtuar e thënë ndaj tyre, çdo vepër e shëmtuar e kryer ndaj tyre, janë shkelje e amanetit.

Familja është një institucion shumë i vjetër, por kurrë i vjetëruar, që ekziston që me krijimin e qenies njerëzore. Pavarësisht se iu nënshtrua goditjeve të ashpra dhe madje edhe likuidimeve gjatë gjithë historisë, ajo shpëtoi nga duart e përgjakshme që dëshironin ta shkatërronin çdo herë dhe e mbajti ekzistencën e saj.

As fuqia i egër i Ispartës së lashtë, dhe as diktaturat arbitrare të këtij shekulli, nuk ishin në gjendje të hiqnin shtëpinë që dora e urtësisë e vendosi në tingullin e natyrshtësisë, dhe ta largonte nga jeta e tyre.

Sepse, Krijuesi Suprem, i cili e dha universin me një rend poetik, e vlerësoi familjen si pjesën më të rëndësishme të këtij rendi të zakonshëm. Kjo pjesë e rëndësishme, e vendosur në gjirin e natyrës, është gjithashtu e lidhur ngushtë me forcat repulsive dhe tërheqëse të botës së sotme.

Shtë sikur nuk ekziston asnjë krijesë e gjallë midis qenieve të gjalla që nuk formon familje edhe për një periudhë të caktuar, dhe nuk përgatit mediokër që pasardhësit e tyre të rriten. Zogjtë krijojnë një fole duke u përballur me një mijë sfida. Milingonat nuk ndalojnë së bëri vrëma në tokë pa u ndalur. Të gjitha kafshët e egra që enden nëpër male, vendosen poshtë shtresës së varrit dhe shkurreve dhe vendosin kokat e tyre atje.

E gjithë kjo na frymëzon të tregojmë se çdo gjallesë ka shtëpinë e vet, private, duke na treguar karakteristikat e rendit të thurur në univers. Megjithatë këto lëvizje duken të pavetëdijshme, harmonia në të tregon kërkesën hyjnore.

Në fakt, e gjithë kjo tregon diçka për një qenie të vetëdijshme njeriun. Por, si për çdo gjë, unë mendoj, në këtë institucion që kërkon shumë kujdes dhe vëmendje, nuk mund të jetë aq i ndjeshëm dhe nuk mund t'i japë atij aq vlerë dhe rëndësi sa është e nevojshme.

Familja është një institucion shoqëror që e siguron vazhdimin e llojit njerëzor si pasojë e marrëdhënies biologjike, ku për herë të parë paraqitet procesi i socializimit, ku marrëdhëniet e ndërsjella lidhen me disa rregulla e norma, ku bëhet bartja (përcjellja) e pasurive dhe vlerave materiale e shpirtërore nga brezi në brez dhe që ka dimensionin e saj biologjik, psikologjik, ekonomik, shoqëror, juridik e të ngjashëm.

Funksioni edukativ:

Fëmija, kulturën e shoqërisë, njohuritë profesionale i merr në familje. Të mëdhenjtë e familjes kanë ndikim të veçantë e të padiskutueshëm në edukimin e fëmijës. Në këtë kuptim familja është një mjedis socializimi, ku fëmija me ndihmën e të rriturve bëhet anëtar i barabartë dhe i pjekur i shoqërisë.

Statistikat në Gjermani:

Sot në Gjermani çdo i treti person jeton i vetmuar. Çdo e treta martesë përfundon me shkurorëzim. Çdo i katërti fëmijë rritet pa nënë ose pa baba... Sipas statistikave, 8 ose 9 % e çifteve të martuara nuk dëshirojnë fëmijë. Në Gjermani çdo 100 gra në vit lindin 129 fëmijë. Kurse në vitet 1960 shkalla e lindshmërisë ka qenë dyfish më e lartë se e sotmja. Që të mund popullsia gjermane ta ruajë nivelin e sotëm që ka, duhet që çdo 100 gra të lindin 260 fëmijë në vit.

Familja në botën myslimane:

Lloji më i theksuar i familjes që haset gjetiu në botën islame është familja e gjerë dhe kryesisht patriarkale. Ajo është e lidhur ngushtë me mësimet dhe pikëpamjet kur'anore lidhur me familjen ngase, në masë të madhe, është brumosur e ngjeshur sipas tyre. Krahas pjesëtarëve të familjes bërthamë – babait, nënës dhe fëmijëve të pamartuar – familja muslimane përfshinë gjithashtu edhe gjyshin,

gjyshen, mixhallarët, hallat dhe pasardhësit e tyre. Familjet muslimane zakonisht jetojnë në 'banesa të gjera', që do të thotë se anëtarët e tyre jetojnë bashkërisht nga tri ose më shumë gjenerata të afërmish në një objekt banimi ose kompleks banesash. Gjithashtu, aty ku ky version i banimit të familjes së gjerë nuk është i mundur, lidhjet familjare arrijnë larg familjes bërthamë, gjë që mund të shihet në lidhjet e fuqishme psikologjike, shoqërore, ekonomike, madje edhe politike. Këtu dua të përkujtoj një thënie të njohur të hazreti Aliut, halifit të katërt pas Muhammedit a.s. (alejhi's-selam), i cili ka thënë: "Mos vlerëso të vërtetën me fjalët dhe sjelljet e njerëzve, por njerëzit me kriteret e së vërtetës!".

Familja te muslimanët shqiptarë:

Edhe te shqiptarët muslimanë haset pothuajse e njëjta strukturë familjare sikurse ajo e botës dhe trungut musliman. Edhe familja muslimane shqiptare ka strukturë të zgjeruar e të madhe me karakter tradicional, ku jetojnë së bashku nën një çati apo në një oborr disa breza e një shumësi anëtarësh. Përveç babait, nënës dhe fëmijëve të pamartuar, në shtëpinë shqiptare muslimane bashkëjetojnë edhe fëmijët e martuar me pasardhësit e tyre, vëllezërit e babait bashkë me pasardhësit e tyre dhe sigurisht që edhe gjyshi e gjyshja si anëtarë të parë e më të denjë të familjes. Nëpër qytetet shqiptare nuk kemi ndonjë sistem urbanistik aq të theksuar sikur në Perëndim i cili ka jetën dhe dinamikën e vet karakteristike, ku, si të thuash, pamundësohet ekzistimi i familjes së zgjeruar dhe i botëkuptimit tradicional të familjes. Në to vazhdon me të madhe të gjallërojë familja e gjerë me tiparet karakteristike të saj, krahas tendencës së përgjithshme që haset në botë për një pavarësim të të rinjve sidomos nga pleqtë e nga anëtarët e familjes më të gjerë farefisnore. Edhe këtu, pra, ka filluar të bëhet çështje mode familja bërthamë me veçoritë e saj, por në mënyrë e stil lokal, ngase nuk mund të bëhet një shkëputje e menjëhershme dhe e tërësishme nga e kaluara dhe nga kornizat e struktura e familjes tradicionale që ka gjallëruar me shekuj të tërë në këto troje.

Përkufizimi dhe parimet themelore:

Familja është një institucion i frymëzuar nga Zoti. Ajo nuk është zhvilluar nëpërmjet proceseve eksperimentale të evolucionit njerëzor e as rastësisht gjatë rrjedhës së kohës. Kjo është një e vërtetë e kumtuar nga mësimet hyjnore të shpallura nga Zoti dhe është një refuzim i tërësishëm i mësimëve evolucioniste dhe akcidentaliste të Çarls Darvinit e të ndjekësve të tij, sipas të cilëve jeta e njeriut ka filluar në ujë me bashkimin e rastësishtëm të miliona proteinave për të krijuar qelizën e parë të jetës. Familja është një institucion që është paraqitur e zënë fill me krijimin e njeriut. Raca njerëzore është prodhim i këtij institucioni, e nuk është institucioni prodhim i racës njerëzore. Lidhur me këtë Kur'ani fisionik thotë: „O njerëz, bëhuni respektues të bindur të Zotit tuaj, i cili ju krijoi prej një individi, kurse prej tij krijoi gruan, e ndërsa prej tyre krijoi dhe shpërndau shumë burra e grad he bëhuni të kujdesshëm në obligimin tuaj

ndaj All-llahut, në emër të të cilit ju i drejtoheni njëri-tjetrit të bashkuar në një krah. Vërtet, Allllahu është Mbikëqyrësi juaj“ (en-Nisa':1).

Sipas Islamit, pra, institucioni i familjes ka filluar me krijimin e burrit dhe gruas së parë, Ademit dhe Havës a. s., të cilët njëkohësisht e kanë përbërë familjen e parë, e jo që njerëzit e parë të zhvilluar e të evoluar nëpërmjet

seleksionimit natyror nga qenie të tjera fillimisht të kenë jetuar të shpërndarë e të pabashkuar nëpër faqen e tokës e që më vonë duke u vetëdijësuar – përsëri nëpërmjet seleksionimit natyror – të jenë bashkuar e të kenë krijuar familjen. Islami këtë të dytën, teorinë e evolucionit, e hedh poshtë me ajetin e mësipërm dhe e mbështet faktin e krijimit të gjithësisë po edhe të njeriut dhe familjes së parë nga ana e Zotit.

Institucioni i familjes ka qenë prezent që nga njerëzit e parë e deri më sot gjatë gjithë historisë njerëzore. Martesa dhe krijimi i familjeve ka qenë dukuri e hasur si te pejgamberët 7 ashtu edhe te njerëzit e thjeshtë. Përfundimisht është edhe porosi e model i Muhammedit a.s., pejgamber i fundit i Zotit. Ai në një hadith të tijin thotë: "Martesa është pjesë e sunnetit (rregullës) tim, kushdo që largohet nga sunneti im ai nuk është prej nesh". Institucioni i familjes luan rol të rëndësishëm në shoqërinë islame. Ajo është njësi themelore në atë shoqëri dhe është e organizuar në atë mënyrë që të veprojë si bashkësi në miniaturë. Përafërsisht një e treta e Ahkamit (rregullave juridike të Kur'anit) kanë të bëjnë me familjen dhe me rregullimin e harmonisë së saj. Është një gërshetim i tërë i të drejtave dhe obligimeve, që i sigurojnë themelet e jetës familjare e shoqërore në tërësi...

Funksionet dhe qëllimet e familjes:

Si duhet vepruar në familjen, që Islami dëshiron ta konstituojë për ta plotësuar ajo detyrën e saj në jetën e individit dhe të shoqërisë? Familja nuk është fabrikë për shtimin e gjinisë njerëzore. Familja në përgjithësi, edhe pse mbajtja, degëzimi dhe shtimi i sojit të njeriut janë ndër qëllimet e saj kryesore, ka strukturë shoqërore-kulturale dhe luan rol të rëndësishëm në ruajtjen e mekanizmit për të siguruar stabilitet shoqëror, ideor dhe kulturor në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë.

Mbrojtja e moralit:

Islami i ndalon marrëdhëniet jashtëmartesore në të gjitha format e tyre. Marrëdhëniet seksuale nëpërmjet bashkësisë martesore janë i vetmi mekanizëm që siguron kontrollin e plotë në ngatërresat seksuale. Martesa gjithashtu është edhe një ventil sigurimi për moral seksual. Kur'ani martesën e quan hisn –kështjellë, për mbrojtje nga mënyra e shfrenuar e jetës dhe thotë: „Kurorëzohuni me lejen e prindërve të tyre dhe jepni dhuratat tuaja me mirësjellje, si grave që kanë dinjitet të vetin, e jo si atyre të pamoralshme dhe atyre që sillen shfrenueshëm!“ (en-Nisa':25).

Stabiliteti psiko-emocional, dashuria dhe mirësjellja:

Një funksion e qëllim tjetër i martesës është kultivimi i miqësisë psikoemotive dhe shpirtërore. Marrëdhëniet në familje, ndërmjet të gjithë anëtarëve të saj, janë faktori

më i rëndësishëm, veçanërisht ndërmjet burrit dhe gruas, por jo si marrëdhënie të nxitura nga interesi. Ato duhet të jenë marrëdhënie shpirtërore, ndarje e përbashkët e së mirës dhe së keqes, marrëdhënie që kultivojnë dashuri, mirësjellje, mëshirë, miqësi, besim të ndërsjellë, sakrifikim, ngushëllim dhe ndihmë në momentet vendimtare të jetës. Vetëm në kuadër të familjes potenciali shpirtëror i burrit dhe gruas bëhet realitet dhe zhvillon pastërtinë morale brenda dhe jashtë familjes, do të thotë në shoqëri...Vlera e bashkëndjënave në familjet me fëmijë kërkon dashuri dhe mëshirë, sakrifikim të njërit për tjetrin, tolerancë dhe dashuri për të formuar karakter të fortë te anëtarët e familjes. Kjo është familja që siguron klimë të përshtatshme për zhvillimin dhe kultivimin e karakteristikave të veçanta njerëzore. Ky funksion i familjes dhe i martesës është trajtuar në shumë vende në Kur'an, ku thuhet:

“Dhe njëra prej shenjave të Tij (Zotit) është se Ai për ju krijoi gratë që të mund të pushoni pranë tyre dhe të gjeni prehje e qetësi në to, kurse ndërmjet jush vendosi dashurinë dhe mëshirën” (er-Rum:21).

Shoqërorizimi dhe orientimi i vlerave:

Funksioni i shtimi në botë pa gjininë tjetër (babain), arsimimi dhe edukimi i fëmijëve, shkollimi i tyre, orientimi jetësor, formimi i karakterit, ndikimi gradual i kulturës dhe i besimit do të mbeteshin të mangët dhe jo të plotë. Kjo është kështu për arsye se ky aspekt i familjes mbetet kujdes i prindërve deri në moshën madhore të fëmijës. Kuurfarë institucioni tjetër, qofshin edhe disa institucione, nuk do të mund të ndërmerrnin një kujdes të këtillë për këtë funksion – edukimin e fëmijës. Është i gabuar mendimi se kujdestarja, çerdhja, shkolla dhe vendi i punës, që zbatohen në shoqërinë moderne, mund të bëhen zëvendësim i plotë i educates familjare. All-llahu xh.sh. thotë:

“O ju që besoni, mbrojeni veten dhe familjen tuaj prej zjarrit (të Xhehennemit), lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurëzit!...”(et-Tahrim:6). Për rolin e familjes, si bartëse themelore e shoqërisë, na udhëzon edhe Muhammedi a.s. në hadithe të shumta, ku ai thotë se çdo foshnje e lindur lind në Islam, por prindërit e saj mund ta shndërrojnë atë në besim tjetër ose në pabesim. Ai gjithashtu ka thënë: “Çdo baba mund t'i japë fëmijës së vet mësimin dhe arsimimin më të mirë”. “Çdokush që i furnizon tri vajza apo tri motra dhe u jep arsimim dhe edukim të mirë dhe sillet mirë me to, Zoti do t'i ndihmojë që ai të forcohet në këmbë të veta dhe me ndihmën e mëshirës së Zotit të fitojë vendin në Xhennet”.

Sigurimi shoqëror dhe ekonomik:

Familja është pjesë e rëndësishme e sigurimit shoqëror dhe ekonomik të sistemit islam. Drejtësia vendos raportet ndërmjet vlerave morale, kulturore dhe ideore, duke shtuar edhe drejtësinë ekonomike-shoqërore ndërmjet anëtarëve të familjes. All-llahu xh. sh. thotë në Kur'an:

„Dhe martoni të pamartuarat (e të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme! Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton nga mirësia e Tij. All-llahu është bujar, i gjithëdjshëm” (en-Nur:32).

Të këtij karakteri janë edhe mjaft ajete të tjera kur'anore që flasin për kujdesin dhe interesimin që duhet treguar ndaj anëtarëve të familjes si dhe ndaj farefisit të ngushtë e të gjerë. Muhammedi a.s. thotë:

“Kur Zoti t'ju dhurojë ndonjë begati, shpenzoheni për vete dhe për familjen tuaj!”. a. Mbajtja e familjes është detyrë ligjore e burrit, bile edhe atëherë kur gruaja është e pasur. b. Ndhima ndaj të afërmeve është e urdhëruar me rregulla të veçanta. Të afërmit e varfër kanë të drejtë në radhë të parë në zekat dhe në kontribute të tjera, që janë të detyruar t'i japin anëtarët e pasur të familjes. c. E drejta trashëgimore i rregullon obligimet ekonomike brenda structures familjare. Këto obligime materiale shtrihen edhe në farefisin e afërm e të largët. d. Fëmijët e adoptuar bonjakë duhet trajtuar si fëmijën e vet. e. Anëtarët më të vjetër të familjes duhet nderuar e duhet sjellur me kujdes e fisnikëri, dashuri e respekt ndaj tyre. f. Gjithashtu duhet sjellur me përgjegjësi ndaj fëmijëve dhe nipave. g. Qëndrim përgjegjës duhet pasur edhe ndaj anëtarëve të familjes së bashkëshortit e të bashkëshortes.

Zgjerimi i horizontit familjar dhe krijimi i kohezionit shoqëror në bashkësi:

Bashkësia martesore po ashtu përvijon drejt zgjerimit të marrëdhënieve individuale, duke zhvilluar afrinë ndërmjet grupeve të ndryshme dhe të shumanshme, ndërmjet familjeve, fiseve e popujve. I Dërguari i Zotit thotë:

“Lidhjet martesore ndërmjet dy familjeve apo fiseve e forcojnë miqësinë më shumë se çdo gjë tjetër”. Lidhjet martesore janë si ura ndërmjet familjeve, fiseve e bashkësive të ndryshme dhe instrument që me zgjerimin e marrëdhënieve familjare vendos barazinë ndërmjet njerëzve.

Motivi për përpjekje dhe sakrifice:

Martesa në mënyrë të drejtpërdrejtë frymëzon zhvillimin e ndjenjave për përgjegjësi dhe nxit hapat për përpjekje më të madhe në plotësimin e nevojave jetësore dhe përmirësimin e zhvillimit ekonomik. Këto aspekte gjenden edhe në porosinë e Kur'anit, që i nxisin njerëzit të martohen, ku thuhet:

“Dhe maritoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme...” (En-Nur:32). Anëtarët e familjes, pra, duhet të integrohen brenda saj, kurse anëtarët e moshës madhore nuk do të duhej të iknin nga anëtarët e moshuar të familjes. Bonjakët, vetëm atëherë kur është e domosdoshme, duhet strehuar në jetimore. Të varfërin dhe të papunësuarin nuk duhet lënë të jetojnë nga lëmosha. Të gjitha këto probleme të përshkruara si shembuj të zënë në gojë, gjejnë zgjidhje Brenda familjes së rregulluar, që duhet të jetë humane dhe fisnike në plotësimin e nevojave të çdo individi. Ky nuk është vetëm sakrifikim ekonomik, por edhe kujdes i obligueshëm për të gjithë, ndjenjë ndaj nevojave dhe furnizimit të tyre.

Edukata morale në filosofin arabe

Njif vet-vedin

I.Përse duhet të njohim vedin?

Shumica e udhimeve fetare, dhe pothuajse të gjithë këshillat e të parëve të fesë nuk janë tjetër gjë veçse urdhnime dhe këshilla që na jep shkencë e filosofis, për edukatën morale të njeriut. E ç'është edukata morale? Me një fjalë, kjo është: me mbushun detyrën e vet, e me mbush detyrën e vet nuk do me thanë veçse ba të mirën. Sa e thjeshtë duket kjo, apo jo? E megjithëkëtë ne nuk mund ta bajmë të mirën pa u përpjekun.

Të marrim, për shembull, një bujk. Ky bujk, pa ba ndonjë përpjekje të shoqnueme me një vullnet të mirë, a mund të thotë kurrë se: Më duket që nuk mirrsha nga ara ime, një prodhim ma të mirë se ai që mora?

Çfarë ka bamë ky bujk për me ndiem këtë mjaftimi? I kanë dhënë këtij një tokë për t'i marrun frytin. Kur e ka marrë këtë arë ky para se ta mbjelli, më duket se e ka pa, dhe ka kuptue se çfarë lloj toke është. Atëherë e ka çmue se sa vleftë e çfarë ka toka e tij dhe çfarë mund të marrë e çka mund të presë nga kjo. Mbas këtij shqyrtimi të parë të tokës së tij, e ka caktue të gjithë punimin e tij. Pa këtë shqyrtim a mund të bante gjë ky bujk? Të themi se bante, por sa kohë desh të humbiste tepër me kuptue se çfarë toke ka e si lloj duhet të punohej kjo?

Na, të gjithë, jemi pronarë të një toke për t'u çmuem. Pra, si pronarë të mirë, nuk ju duket se na duhet ma parë të njohim tokën tonë që nuk është veçse vet-vetja e jonë? A thue se nuk duhet të përpiqemi të dimë natyrën tonë që na shtyn të bahemi njerëz të mirë apo të këqij, njerëz të lumtur apo të mbytur në mizori? Kjo nevojë sado që duket çiltaz, prap na shfaqet rrallë. Na po e kalojmë jetën tonë e tërhequn prej dëfrimeve e prej brengave të kohës së tanishme, nuk dimë të gjejmë pesë minuta për të thanë vedit: "Ç'është tek unë, ajo që rregullon jetën time?"

E megjithëkëtë është shumë i nevojshëm e dobishëm të

njohim vedin. Na, kur shohim një gjë të çuditshme, të re, që nuk e dimë, habitemi dhe dëshirojmë të dimë e të kuptojmë se ç'është kjo, si punon, për shembull, në qoftë se është ndonjë vegël a një makinë, e ndiejmë një gëzim kur arrijmë ta marrim vesh; mira pra, është një dëfrim shumë më i madh akoma kur të marrim vesh ç'jemi na kur të kuptojmë si rrojmë. Nuk mund të bahemi të djathtë për këtë gjë veçse dal ka dal. Çdo njeri mund të zakonohet, ta ndiejë vedin të tërhequn nga mendimi i shqyrtimit të ved-vedit, tue pyetur vedin kështu: A jam burr apo frikacak? A jam rrenacak apo i sinqertë? Përse e bana unë këtë gjë? Ç'mund të dalë prej kësaj? A kam rrejtë sot? A jam sjellë me nder? etj., etj.

Tue u sjellun kështu njeriu ban si bujku i urtë që përmendëm më nalt e mund të shpresojë një prodhim të mirë.

Përnjimend një njeri që kontrollon vedin, ka me pa se në një kohë që ishte zemrue fytyra e tij kishte marrë një egërsi të padëshirueshme e ky hidhnim kishte dhanë përfundime jo të pëlqyeme, e pra do të mundohet doemos që ta pushtojë vehten, të mos rrokët prej zemrimit e të jetë gjakftoht. Kjo është një gjë e provueme prej shumë njerëzve të urtë.

Po të mendohemi thellë, do të kuptojmë se një njeri që nuk përpiqet të njohë vedin, nuk mund të ketë asnjë përmirësim të vedit, asnjë përparim moral.

Këto mendonte njeriu më i madh i greqis së vjetër, Sokrati, kur jepte këtë këshillë njerëzve: "Njif ved-vedin tandem!". Ky është kuptimi i fjalës së hazreti Aliut: "Ai që njef ved-vedin, njef Perëndinë." Ndonëse kjo fjalë ka kuptimet filosofike të saj ma të thella, të cilët i shpjegon filozofia e tesarruf, por sidoqoftë kuptimi ma i thjeshtë e ma i kuartë e kësaj fjale, është ai që tregum ma nalt e këtë nuk e mohojnë Ehli tesarrufi...

II.Asht e vështirë me njohun vedin

Sa vështirë është të njohësh vehten. Për të gjykuem fytyrën tonë, kemi pasqyrën, e megjithëkëtë po t'ëna thonë

të vizatojmë mbi letër fytyrën tonë do të hiqnim mundime. Pse do të thoni? Mendohuni njëherë. Të gjitha pasqyrat nuk janë njëlloj e pastaj fytyra e njeriut shfaqet në pasqyrë si mbas dritës së vendit. Ka dhe ma: Kur shikojmë në pasqyrë vehten tonë e gjejmë kurdoherë të bukur. Në qoftë se na thonë që jemi të shëmtuem na kur marrim pasqyrën në dorë për me provue se asht e vërtetë kjo fjalë, themi me vedi: nuk jam i bukur, vërtetë, por s'jam edhe i shëmtuar si thonë! Në qoftë se na thonë që hundën e kemi të madhe apo të shtrembët, menjëherë marrim pasqyrën e themi: Vërtet, por kur më shikon njeri faqas nuk duhet e madhe!

Domethanë se njeriu e ka në natyrë që të mos e shohë veten siç asht, por siç ia ka ënda. E nuk e shqyrton vehten e tij, thotë: Nuk jam njeri sqimtar (fodull). Diku nuk e thonë të vërtetën, por këtë e baj për të qeshur. Shoh rreth meje njerëz të ndyrë, "unë nuk jam si ata". Oh, sa bukur mendojmë për veten tonë. Sedra e jonë, egoizma e natyrshme të njeriut, na bind gjithnjë të mendohemi se jemi njerëz të mirë e ta gjejmë të këstillë veten, e pothuaj pa të metë, të përsosun.

E pastaj asht aq I padëshirueshëm të dish që je njeri plot gabime e që duhet të përpiqesh të ndreqësh veten! Mefshtësia moskujdesja na vijnë, nga ana tjetër menjëherë në ndihmë të sedrës sonë e nga duart e tyre po dalin gjithnjë duke qenë fort të zbukuruem.

III. Si mund të njohim vehten?

Ç'do të bajmë pra për me njoftun vehten tonë? E para gja për të bamë asht me u armatosun me një vullnet të fortë. Duhet të duem të njohim vet-vehten; ta duem këtë gja e sa të mundim t'i dëbojmë tri sendet që ndalojnë veprimin tonë në këtë lamë. Këto tri sende janë: Sedra, mefshtësia, moskujdesja. Kur t'i ndjekim këto, atëherë vetëm mund ta kqyrim vehten me një sy të kuartë.

Gjaja që duhet në tesavuf, "me dliun veten" nuk asht gja tjetër veçse kjo. Gjaja që quhet shkalla ma e fundit që

quhet beksa lul-la ekcaz, arabisht që domethanë, me e shkrin vehten në Perëndinë, poshtë e lartë domethënë me shpëtue nga ndjenjat egoistike, mos me pas ambicie dhe pasione shtazore...

Çdo theory po s'u zbatue, domethënë çdo mendim po s'u ba vepër, nuk mund të ketë vlerë pohuese për jetën tonë. I bie me i vu në praktikë pra këto mendime? Qe: duhet të bajmë, çdo natë, provimin e ndërgjegjes s'onë. Natën, kur kemi rënë në dyshek, kur jemi Brenda në rehatin e shtratit tonë larg nga poterja e jetës së përditshme, asht një kohë që ndiejmë që jemi të vetëm me vet-vehten tonë, të vetëm me ndërgjegjen tonë.

Një çast i mirë që të shikojmë nga mendja, një nga një veprimet e ditës që kemi kalue. Një orë e mirë për të gjykuar vehten tonë. Por duhet të jemi gjykatës të paanshëm në këtë çast. Të mos na vijë turp, por, burrnisht, të themi: "Sot bana këtë gabim, nuk jam sjellun mirë, por nesër, do të vijë një ditë, të jeni të sigurt që do ta pushoni vehten tuaj e nuk do të keni përse të skuqeni kur e gjykoni vehten natën."

Kjo asht me qenë një njeri i disiplinuem, si thonë djjetarët e Evropës. Po ta kini pushtue vehten, do të jemi shumë të kënaqun nga vehtja juaj...


Fundi, për të gjykuem mirë vehten tuaj, dëgjoni gjykimet e të tjerëve të bame mbi ju, veçanërisht dëgjoni dhe pranoni me kënaqësi gjykimet e atyne që ju duen të mirën.

Kështu, vehtja e jonë asht një shesh studimi për ne. Të kqyrim vehten tonë faqas e dal ka dal do të mbërrijmë ta njohim e ta punojmë tokën tonë për të marrun frytin e kërkuar...

Nebil Çika

"Zani i Naltë", nr. 3, dhjetor 1923, f. 80-85.

Marriëveshja e Hudejbijes



Mendimi i Omerit (r.a.) për Paqen e Hudejbijes

Ibni Abasi (radijallahu anhu) ka treguar se Omeri (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "I Dërguari i Allahut u mor vesh me popullin e Mekës në një pikë të atillë, duke u njohur atyre një privilegj aq të madh, që sikur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) të më kishte vendosur një prijës mbi krye dhe ai të vepronte njësoj siç veproi Resulullahu as nuk do ta dëgjoja, as nuk do t'i bindesha. Ja se cila ishte ajo pikë: "Ata që bëheshin myslimanë dhe arratiseshin nga radhët e idhujtarëve dhe vinin për t'u strehuar te myslimanët, pala e besimtarëve duhet t'i kthente sërish mbrapsht tek idhujtarët. Kurse ata nuk do t'i kthenin të kthyerit që shkonin për të kërkuar strehim pranë tyre."


Mendimi i Ebu Bekrit (r.a.) për Paqen e Hudejbijes

Ebu Bekri (radijallahu anhu) thoshte kështu: "Asnjë ngadhënjim i arritur prej Islamit nuk ka qenë një fitore aq madhështore sa ç'ishte ngadhënjimi i Mekës. Por, atë ditë, me direktivat e Zotit tonë dhe të Profetit të profetëve, horizonti i njerëzve nuk ishte edhe aq i gjerë. Njerëzit nguteshin. Mirëpo, Allahu nuk ngutet, siç bëjnë rëndom robt e Tij, derisa të vijë çasti i duhur, që punët hyjnë në vijën e tyre. Gjatë Haxhit të Lamtumirës, pashë njëherë Suhejl bin Amrin, i cili kishte qenë mëkëmbës e përfaqësues i kurejshëve për Marrëveshjen e Hudejbijes. Qëndronte në këmbë në vendin ku ishin duke u therur kurbanet, e Resulullahu sillte një e nga një devetë e caktuara për kurban. Pastaj Profeti ynë thirri berberin, i cili na preu flokun të gjithëve. Unë rrija dhe sytë i hidhja andej nga Suhejli. I Dërguari i Allahut i mblidhte flokët e prerë dhe më duket se i vinte mbi flokë. Në atë çast m'u kujtua kundërshtimi i tij në Hudejbije, që nuk pranonte me ngulm që të shkruhej 'Bismil'lahi'r-Rahmani'r-Rahim', apo 'Muhamedi, i Dërguari i Allahut' dhe falënderova Allahun që tanimë e kishte nderuar atë me pranimin e Islamit!"

Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"

M. Jusuf Kandehleui

Botim i KMSH



ISMAIL MAÇI

VEPRIMTAR I SHQUAR TIRANAS

(1885-1960)

Ismaili lindi më 24 maj 1885 në një familje të vjetër tiranase, e ardhur dy shekuj më parë nga Shupali dhe e njohur për qëndrimin që mbajti gjatë anarkisë feudale në shekujt XVII-XIX përkrah familjes Bargjini (Tirana). Gjyshi i Ismailit, Haxhi Musa Maçi, në fillim të shekullit XIX e shpëtoi nga kundërshtarët toptanas djalin e vetëm të Bargjinëve, në moshë të vogël, Haxhi Et'hem Beun dhe nuk iu nda derisa e rriti dhe e edukoi jashtë shtetit

duke e bërë alim (të ditur) me famë. Et'hem beu është ndërtuesi i xhamisë që sot mban emrin e tij. Ai hapi një medrese në Tiranë dhe shkroi 4 divane në gjuhën shqipe me alfabet arab.

Po në familjen e Haxhi Et'hem Beut, te trashëgimtari i tij Qazim bej Tirana, në Durrës qëndroi Ismaili për disa vjet, derisa mbaroi shkollën ruzhdije (të mesme turke).

Ishte koha kur ndryshimet në jetën shoqërore po

bënin realitet formimin e bashkësisë kombëtare ku rolin vendimtar e luanin bartësit më autentikë të jetës kombëtare - inteligjenca e mbështetur fort në parimet e moralit islam, që në Tiranë ishte bërë qysh me themelimin e qytetit, sundues në tërë shoqërinë.

Një intelektual i tillë nisi të bëhej edhe Ismaili. Ai ishte ndër veprimtarët e shoqërisë së krijuar për lirinë dhe shkollën shqipe qysh në vitin 1896 e që funksiononte ilegalisht për të sjellë në Tiranë dhe në rrethet e saj libra dhe gazeta shqipe të botuara në kolonitë shqiptare të Rumanisë, Bullgarisë, etj.

Edhe në mbrojtjen e pavarësisë e të çështjes kombëtare në vitet 1912-1914, Ismaili qëndroi krahas shqiptarëve në luftë me osmanët që e arrestuan dhe e mbajtën në burg së bashku me 125 shokë të tij patriotë tiranas dhe me 30 të tjerë jabanxhi (jo tiranas, por me banim në Tiranë).

Tirana, në kushtet e reja që u krijuan me mbarimin e Luftës së Parë Botërore, mbeti përsëri një qendër nga më të rëndësishme në Shqipëri. Popullsia e Tiranës, sikurse i gjithë populli ynë, mbante një qëndrim të theksuar patriotik. Në këtë kohë në Tiranë qenë grumbulluar e kryenin veprimtari të gjatë edhe patriotë të njohur jabanxhi si Hasan Prishtina, Sotir Peçi dhe shumë imigrantë të tjerë kosovarë e dibranë si: Vehbi Dibra (Agolli), etj., kështu që në Tiranë lëvizja patriotike po dilte nga kuadri i saj lokal.

Në Tiranë u vendos qeveria, u bë kryeqyteti i shtetit të ri shqiptar më 1920. Në vitin 1923, Ismaili që ndër bashkëpunëtorët më të afërt të Vehbi Dibrës, në organizimin e Komunitetit Musliman Shqiptar ku, përveç të tjerave, i vunë organizmat fetare të masës dërrmuese të popullsisë në vendin tonë myslimanëve - mbi bazat kombëtare administrativisht e organizativisht jashtë ndikimeve politike të huaja, të dëmshme dhe antipatriotike. Me këto vendime u vunë në jetë idealet e rilindësve tanë për sigurimin e bashkimit dhe vëllazërimit kombëtar të mbarë shqiptarëve pa dallim besimi.

Fill pas këtij kongresi historik nisi puna për t'i vënë në jetë vendimet e tij e filloi botimi i revistës së parë të Komunitetit Musliman me emrin kuptimplotë "Zani i Naltë". Ismail Maçi u ngarkua me drejtimin e saj, detyrë që e kreu me devotshmëri prej vitit 1923 deri në vitin 1926.

Qysh në programin e revistës, botuar në titullin "Parathanë e qëllim" në faqen 3-6 të numrit 1, në tetor 1923, thuhet: "Asht për t'u vajtuar për të vërtetë gjendja e sotme, në çdo pikëpamje e Komunitetit Muhamedan në Shqipëri... Na të përkoshmes, pra, do ta kemi për qëllim me u munduem e me i ndaluem hovin këtij shkatërrimi që shihet n'elementin mysliman shqiptar, tue i dhanun këtij shkas për të bërë ma të kërthnesët kah përparimi e qytetnimi kohotar...", përcaktohen objektivat e saj e të Komunitetit Musliman (Xhemati Islamije) për 1) Me bashkuem... popullin Musliman Shqiptar. 2) Me përmirsuem gjendjen... e institucioneve Muslimane... 3) Me ia zbuluem popullit Musliman shqiptar të vërtetat e besimit... 4) Me plotsuem vllazninë ndërmjet të gjithë elementeve në Shqipëri. 5) ... me forcuem edhe themelet e një politikës së shëndoshë e thjesht kombëtare në shtetin tonë".

I tërë ky numër përfshin drejtimet e revistës që "merret me filozofi, moral, literaturë kombëtare". Kështu, në faqet 7-9, në poezinë kushtuar Muhamedit a.s., në strofën e parafundit bëhet lutje: "Sa t'jetë jeta mbretëroftë / Dija, përparimi, atdheu lulëzoftë".

Në faqet 10-13 përshkruhet me hollësi falja "e para xhuma e xhemati islamijes" në Xhaminë e Vjetër të Tiranës ku "Zani i Myftiut (Vehbi Dibra - Agolli) e gjuha amtare me gjithë forcën e saj filloi të përndajë shpresë prej minberit", "Myftiu duke folur për udhrat e Perëndisë...". Pika e parë janë urdhnat që i përkasin kësaj jete: prej ktyne ma e para asht dashtunia e Atdheut".

Në faqen 14-16, nën titullin "Pika e moralit e filozofia", duke folur për injorancën, përmend gjëra me aq rëndësi edhe për sot: "Sheh me të keq shokun e vet, larg të dijshtmit... idhnohet shpejt, flet kot, i jep dhanti të pameritueshtmit, mbulon mëshfësit, i beson kujtdo, nuk din të dallojë mikun prej armikut".

Ndërsa në faqen 16-21 artikulli "Me çfarë mund të rrojë myslimani i sotëm?" mbyllet me këshillën aq të vlefshme për kohën: "Religjioni na urdhëron nderimin e femnave, që do të përgatisin një botë të re në Shqipëri".

Duke punuar natë e ditë për të bërë realitet këtë program madhështor, kryesia e Komunitetit Musliman arriti ta ngrejë edhe shpirtin mysliman shqiptar në nivelin e duhur e të zhvillojë një varg aktivitete me rëndësi kombëtare duke e bërë qytetarin mysliman luftëtar të së resë përparimtare kudo në Shqipëri. Revista "Zani i Naltë" qëndroi gjithmonë në lartësinë e duhur si zëdhënës i kësaj kryesie.

Prandaj, fillimisht është çmuar e çmohet roli i kësaj reviste në edukimin e masave myslimane në mbarë Shqipërinë krahas për krahas me institucionin kryesor - Medresen e lartë, që u bë farkëtuesja e kuadrit të përhapjes së mësimi islam në çdo skaj të Shqipërisë.

Gjatë viteve 1930-46, zyra avokatore në Pazarin e Vjetër, ku ai punonte si shkruer publik, ka qenë qendër e klerikëve myslimanë tiranas. Aty gjendeshin ndër të tjerë Hafiz Ibrahim Dalliu, Sulejman Kadiu, Haxhi Mahmud Dashi, por edhe Hafiz Ali Korça, Hafiz Ismet Dibra e të tjerë.

Në vitet e demokracisë, në vitin 1995, për punë të paprerë në shërbim të popullit, u dekorua me medaljen "Për veprimtari patriotike" me motivacionin: "Ka kontribuar në luftën për çlirimin kombëtar e pavarësinë e vendit. Është shquar në përhapjen e arsimit shqip".

Gjatë kohës që jetoi, Ismail Maçi punoi me devotshmëri, i pajisur me parimet e larta të fesë islame. Populli i Tiranës e zgjodhi disa herë me radhë përfaqësues të vetin në Këshillin Bashkiak dhe, për çdo zgjedhje të deputetëve, si zgjedhës të dytë. Materialet e arkivit të Bashkisë ruajnë të dhëna se sa me vendosmëri Ismail Maçi mbronte interesat e popullit të thjeshtë.

Ndërroi jetë më 10 janar 1960 dhe u varros me nderime nga populli e me shërbimet fetare të zakonshme të xhematit.

Shoqëria e mirë



Në regjistrat e historisë së lavdishme islame kanë hyrë shumë emra. Po a kemi menduar ndonjëherë se kujt i dedikohet kjo mirësi? Ishte pikërisht shoqërimi me Profetin a.s. Nëse Ebu Bekri, Omeri, Osmani, Aliu, etj., nuk do të ishin shoqëruar me Profetin a.s., nuk do të njiheshin ashtu siç njihen edhe sot e kësaj dite.

Profeti a.s. ka thënë: "Atë njeri, të cilit Zoti ia do të mirën, i jep një shok të mirë. Nëse harron e kujton dhe kur e kujton, e ndihmon."

Ndaj, më i miri shok, është ai që të ndihmon ta njohësh dhe ta adhurosh Zotin, ai që bëhet shkak të udhëzohesh në rrugën e drejtë.

Çdo çast i jetës ka treguar se sa sipërfaqësore janë marrëdhëniet e ngritura mbi interesa të caktuara dhe se e vetmja lidhje e sinqertë dhe që vazhdon deri në pafundësi, është lidhja për hir të Zotit. Profeti a.s. ka thënë: "Ditën e Kiametit, do të vendosen rreth Arshit podiume prej drite, mbi të cilat do të qëndrojnë njerëz që kanë veshur rroba prej drite dhe fytyrat u ndriçojnë. Nuk janë as profetë, as dëshmorë. Vetë profetët dhe dëshmorët i kanë zili... Ata janë njerëz, që e kanë dashur njëri-tjetrin për hatër të Zotit, jo për shkak të gjakut dhe miqësisë e as për shkak të pasurisë e posteve".

QËLLIMI I MIRË

Hadithi "Veprat vlerësohen sipas qëllimit", interpretohet ndonjëherë me kuptimin se qëllimi i mirë i justifikon edhe veprat e këqija dhe i kthen mëkatet në vepra që meritojnë shpërblim. Kjo është krejtësisht e gabuar. Mëkati mbetet mëkat, pavarësisht se sa i mirë mund të jetë qëllimi. Për shembull, nëse dikush hyn me forcë në një shtëpi të huaj dhe vjedh me qëllimin për ta dhënë gjithçka për bamirësi ose lëmoshë, ai njeri mbetet hajdut dhe meriton ndëshkimin përkatës. Qëllimi i tij i mirë nuk e justifikon atë dhe as mëkati nuk i falet.

Nga ky hadith kuptojmë se:

1. Një vepër e mirë është adhurim kur bëhet me qëllimin e mirë. Për shembull, falja bëhet adhurim vetëm kur njeriu lutet për të arritur kënaqësinë e Zotit dhe jo për të rënë në sy.

2. Interpretimi i dytë është se nga kryerja e veprave të lejuara nuk fiton as shpërblim dhe as nuk ndëshkohesh, por nëse ato bëhen me qëllimin e mirë, ato bëhen vepra adhurimi. Për shembull, ngrënia është e lejuar, por nëse ha me qëllimin që ushqimi të të japë energji dhe atë energji ta përdorësh në shërbim të së mirës, kjo vepër kthehet në adhurim, për të cilën do të shpërblehesh.



PËRSHËNDETJA

Përshëndetja e vëllait mysliman është prej praktikave islame, që është shenja dalluese e një myslimani. Vlera e saj është treguar në shumë hadithe. Myslmani duhet të përshëndesë jo vetëm ata të cilët i njeh, por edhe të panjohurit.

Profetin a.s. e pyetën se cilat janë vepra të mira për myslimanët. Mes veprave që i përmendi ishte: "Ju duhet t'i përshëndesni njerëzit, i njihni apo nuk i njihni".

Është prej traditës profetike të përshëndesësh familjen kur hyn në shtëpi.

Profeti ynë a.s. e udhëzoi shërbëtorin e tij, Enesin: "Kur të hysh në shtëpi, përshëndeti familjarët e tu. Ky veprim është në dobinë tënde dhe të familjarëve të tu." (Tirmidhiu)

Përshëndetja me selam është e pëlqyeshme, vetëm kur personi të cilin do të përshëndesësh, nuk është i zënë dhe kur përshëndetja nuk e shqetëson atë. Nëse përshëndetja jonë e pengon nga ajo që po bën, për shembull po lexon Kur'an, po përkujton Zotin, po lutet, apo po bën diçka që nga humbja e vëmendjes shkaktohet dëm, duhet të presim derisa të përfundojë.

SHPËRBLIMI I TË MIRËVE

Abdul Kadir Xhejlani tregon: "Që në fëmijëri isha edukuar të mos gënjej. Një ditë u nisa për në Bagdad në kërkim të diturisë dhe nëna ime më dha 40 dinarë me vete për nevojat e mia dhe si gjithmonë, më porositi që të jem i sinqertë. Rrugës më dolën para disa hajdutë dhe njëri prej tyre m'u afrua dhe më pyeti se çfarë kisha me vete. Unë i tregova se kisha 40 dinarë. Ai mendoi se po tallesha dhe u largua. Kurse një tjetër më bëri të njëjtën pyetje dhe unë iu përgjigja si më parë. Ai, i çuditur, më pyeti se çfarë më shtyu të mos gënjeja. Unë i thashë se i kisha dhënë besën nënës se kurrë nuk do të gënjeja dhe se nuk do ta thyeja atë betim. Kur dëgjoji këtë i pari i tyre, filloi të thërriste me zë: "Ti po frikësohesh se mos po shkel besën që i ke dhënë nënës, ndërsa unë nuk frikësohem që po shkel besën që i kam dhënë Allahut!" Pastaj dha urdhër që t'i kthehet karvanit gjithçka që i ishte grabitur.

Pastaj u drejtua nga unë dhe më tha: "Unë pendohem tek Allahu para teje."

Dhe të tjerët ndoqën shembullin e tij dhe u penduan të gjithë.

Lejla Dervishi



BOTIMET KMSH



”

LIBRI ËSHTË NDARË NË GJASHTË KAPITUJ, DUKE PËRMBLEDHUR NË VETVETE ÇËSHTJE DHE NËNÇËSHTJE. ATY TRAJTOHEN ME RADHË ÇËSHTJET E THIRRJES NË ISLAM DHE PARIMET E SAJ, CILËSITË DALLUESE TË KUMTUESIT DHE METODAT QË AI DUHET TË NDJEKË NË KUMTIM, VEÇORITË E LIGJËRIMIT DHE SPECIFIKAT KU LIGJËRUESI DUHET TË BËJË KUJDES, PLANI DHE PËRGATITJA E HUTBES DHE VAZIT, SI DHE DETYRAT QË GËZOJNË IMAMI E MYEZINI.

WWW.KMSH.AL



BOTIM I RI